

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS



SUBJEKTI : «TREBESHINA L.t.d» Sh.p.k

Klasifikimi i projektit: Në bazë të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca II Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ky aktivitet përfshihet në pikën 10.h "Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujrave nentokesore".

**PROJEKTI : «NXJERRJA E UJIT NENTOKESOR DHE SKEMAT E TJERA PER RIMBUSHJEN
ARTIFICIALE TE UJRAVE NENTOKESORE»**

ADMINISTRATOR: HARI LENA

**VENDODHJA: GRYKA E KELCYRES, ZONA TURISTIKE, RRUGA TEPELENE – KELCYRE,
BASHKIA KELCYRE, RRETHI PERMET, QARKU GJIROKASTER.**

TABELA PERMBLEDHESE

1. HYRJE
2. IFORMACION PER QELLIMIN E RAPORTIT PARAPRAK TE VNM
& METODIKE E ZBATUAR
 - 2.1 .PËRSHKRIMI I QËLLIMIT TE PROJEKTIT
 - 2.2 .OBJEKTIVAT E E RAPORTIT PARAPRAK TE VNM
 - 2.3 .PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE
INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN
 - 2.4 .LEGJISLACIONI KRYESOR SHQIPTAR PËR HARTIMIN DHE KLASIFIKIMIN E
RAPORTIT PARAPRAK TË VNM-SË
 - 2.5 .PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL
 - 2.6 .PËRSHKRIM TË METODIKES TË ZBATUAR PËR HARTIMIN E RAPORTIT
PARAPRAK TË VNM-SË
 - 2.7 .METODIKAT E ZBATUARA DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT
- 3 PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQESKU ZHVILLOHET PROJEKTI
 - 3.1 .ZONAT E MBROJTURA
 - 3.2 .BIODIVERSITETI
 - 3.3 .PEISAZHI
 - 3.4 .CILESIA E AJRIT
 - 3.5 .TE DHENA PER GJENERIMIN E MBETJEVE URBANE DHE INERTE
 - 3.6 .ZHURMAT
 - 3.7 .MJEDISI SOCIAL-EKONOMIK
- 4 INFORMACION PER AJRIN DHE UJRAT NE ZONE KU DO TE ZHVILLOHET
PROJEKTI.
 - 4.1. KUSHTET HIDROLOGJIKE.
 - 4.2. KOMPLEKSI UJEMBAJTES I KIJATERNARIT Q
 - 4.3. PERBERJA KIMIKE E UJRAVE
 - 4.4. ORIGJINA E UJRAVE SIPERFAQSOR DHE E NENTOKESOR
 - 4.5. CILESIA E UJRAVE NENTOKESORE
 - 4.6. REGJIMI HIDRODINAMIK I RAJONIT
 - 4.7. ZGJEDHJA E VARIANTIT NGA INVESTITORI PER FURNIZIMIN ME UJE
 - 4.8 .ULJA ME SHPIM NE PUSIN E PROJEKTUAR

- 9.4. VENDODHJA E IMPJANTIT/INSTALIMIT
- 9.5. INFRASTRUKTURA RRUGORE
- 9.6 . PERSHKRIMI I PROJEKTIT/ZBATIMIT
- 9.7. KRAHASIME PER KONKURENCEN
- 9.8. OBJEKTIVAT E MARKETINGUT
- 9.9. TRANSPORTI,PAISJET DHE MJETET TRANSPORTIT
- 9.10. ÇELSI I SUKSESIT
- 9.11. OBJEKTIVA E PRODHIMIT
- 9.12. PRODUKTET DHE KAPACITETI
- 9.13. HAPSIRA E PERGJITHSHME E STABILIMENTIT
- 9.14. HAPSIRA E JASHTEME
- 9.15. ZONA JASHTE NDERTESAVE DHE NDERTESAT
- 9.16. HAPSIRA E BRENDESHME E NDERTESAVE
- 9.17. PROJEKTIMI,KONSTRUKTIMI DHE MIREMBAJTJA
- 9.18. NDRIÇIMI
- 9.19. VENTILIMI
- 9.20. VENDET E HEDHJES SE PLEHRAVE DHE SHKARKIMET
- 9.20. HAPSIRA E MATERIALEVE TE PA PERDORSHME
- 9.21. SHERBIMET SANITARE,SHERBIMET NDAJ PERSONELIT PUNTOR
- 9.22. PAISJET E PASTRIMIT DHE SHERBIMIT SANITAR
- 9.24. INFRASTRUKTURA SHTESE
- 9.25. VENDODHJA E PROJEKTIT

10 INFORMACION LIDHUR ME MODIFIKIMIN E NDIKIMEVE NE MJEDIS

11 MASAT E PROPOZUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

12. PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR

13. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË
ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT

13.1. QELLIMET E MONITORIMIT MJEDISOR

13.2. OBJEKTIVAT E MONITORIMIT

**5 INFORMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMIT NE MJEDISIN KU
ZHVILLOHET PROJEKTI**

**5.1. NDIKIMET E IMPAKTEVE POTENCIALE NEGATIVE NE MJEDISIN E ZONES
SE PROJEKTIT**

**5.2. NDIKIMET E IMPAKTEVE POTENCIALE POZITIVE NE MJEDISIN E ZONES
SE PROJEKTIT**

6 MUNDESITE E REHABILITIMIT PER MBROJTJEN E MJEDISIT

**7 MASAT E MUNDESHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE GJATE
ZHVILLIMIT TE PROJEKTIT**

7.1. TE PERGJITHSHME

7.2. VLERESIMI I IMPAKTEVE KRYESORE NE MJEDIS

7.3. NDIKIMET NE AJER

7.4. NDIKIMET NE UJERA

7.5. NDIKIMET NGA MBETJET E LENGETA

7.6. NDIKIMET NE TOKE

7.7. NDIKIMET NE BIODIVERSITET

7.8 .NDIKIMET NE MJEDISIN SOCIAL EKONOMIK

7.9 .NDIKIMET QE SHKAKTOJNE NDRYSHIME KLIMATERIKE

7.10.NDIKIMET NE RREZATIM

7.11.PER TRAJTIMIN E MBETJET TE NGURTA

7.12. PER MINIZIMIN E ZHURMAVE DHE VIBRIMET

7.13. PER ELIMINIMIN E RASTEVE AKSIDENTALE SI ZJARRE E TYMRA

7.14. PER RREGULLAT E SIGURIMIT TEKNIK

8 NDIKIMI NE MJEDISIN NDERKUFITAR TE PROJEKTIT

9 PËSHKRIMI I PROJEKTIT DHE I VENDODHJES SE TIJ

9.1.HYRJE

9.2.TE PERGJITHSHME

9.3.QELLIMI I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

13.3. BAZA LIGJORE E MONITORIMIT

13.4. KERKESAT LIGJORE PER KRYERJEN E MONITORIMIT

14. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

1.HYRJE

Mjedisi eshte burimi i gjithçkaje per te cilen njerezit kane nevoje per te jetuar dhe per tu zhvilluar.

Sa me i degraduar te jete mjedisi aq me keq ndikon ne shendetin e njeriut dhe zhvillimin ekonomiko-social, prandaj duhet nje menaxhim sa me mire i mjedisit.

Vendi yne eshte anetare i nje numri konventash nderkombetare, si rrjedhoje eshte i detyruar te zbatoje nje sistem sa me efektiv ne fushat ekonomik-social-mjedisor, per rregullimin e territorit sidomos ne funksion te zgjidhjes se problemeve te ndryshme mjedisore.

Ligji i Vleresimit te ndikimit mjedisor nr.10 440 date 07-07-2011 mbi "Vleresimin e Ndikimit Mjedisor" ne Shqipëri thekson per pergatitjen e vleresimeve mjedisore te çdo projekti te zhvillimit qe mund te shkaktojne ndikime ne mjedisin e vendit.

Ky Raport Paraprak i VNM-je eshte pergatitur sipas kerkesave kombetare te mbrojtjes dhe ruajtjes se mjedisit te permendura me poshte si dhe sipas legjislacionit te BE-se marrë si referencë. Legjislacioni Kombëtar i Shqipërisë percakton rregullat dhe menytrat per kryerjen e një VNM te kesaj natyre, te cilat konsulentët i kane konfirmuar. Ligji ka theksuar per mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit natyror dhe burimet e tij duke e konsideruar ate si pjesë e trashëgimisë kombetare e cila duhet te ruhet dhe te mbrohet per te mirene e gjeneratave te ardhshme. Mbrojtja e mjedisit dhe burimeve te tij eshte një pararendës kyç per zhvillimin e qendrueshëm te vendit.

Ky Raport Paraprak i VNM-je do te identifikoje ndikimet e mundshme ne mjedis te punimeve te propozuara per "**Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore**", me theks te vecante ne rekomandimet mbi zvogelimin e ndikimit dhe marrjen e masave te nevojshme per te minimizuar ndikimet qe mund te lindin gjate periudhes se zhvillimit te projektit.

Raporti Paraprak i VNM-se do te diskutoje gjithashtu mbi justifikueshmerine e projektit, alternativat e vendosjes se komponenteve te projektit te tilla si planet e projektit dhe konsideratat mjedisore. Raporti per me tepër do te siguroje një plan per lehtësim dhe një program monitorimi te cilat mund te zbatohen gjate zhvillimit te projektit.

Raporti Paraprak i ndikimit ne mjedis do te paraqese nga njera ane rendesine e zbatimit te projektit "**Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore**" pershkrimin e ketij projekti dhe nga ana tjetër ndikimet negative kryesore ne mjedis, masat zbutese per te minimizuar sa me shumë te jete e mundshme keto ndikime negative, duke llogaritur se si qendron ekuilibri ndërmejt tyre per te arritur një zhvillim te qendrueshëm.

Te paraqese realizimin e ketij projekti dhe zhvillimin ekonomik qe perfitohet prej zbatimit te tij, por gjithmonë duke mbrojtur mjedisin, duke patur parasysh parimin "e zhvillimit te qendrueshëm". Ky dokument prezanton gjithashtu dhe pale te marrin pjesë, perfitojne apo preken nga zbatimi i tij.

Raporti paraprak i VNM-ja eshte perpiluar bazuar ne te dhënat cilësore dhe sasiore te mbledhura nga ekspertët e kontraktuar te cilet gjate inspektimeve ne terren dhe vleresimeve te kryera ne muajt shtator-tetor 2015. Megjithate, vleresime te bera nga konsulentët te ndryshem ne vitet e meparshme jane shfrytezuar gjate pergatitjes se raportit. Te dhënat afatgjata mbi disa aspekte te tilla si meteorologjia,

sizmiciteti zonës, të dhënat gjeomorfollogjike dhe klima janë mbledhur nga kalkulimet dhe studimet e realizuara nga inxhinieri projektues, si dhe nga burime dytësore përmes raporteve të publikuara më parë dhe të databazave globale.

Kjo edhe për vetë faktin se **Kelcyra** është një zonë mjaft e rëndësishme, jo vetëm për pozicionin gjeografik që ka, por edhe për vlerat dhe resortet që mban.

Objekti ku do të zhvillohet aktiviteti në një sipërfaqe të mjaftueshme për implementimin e projektit në zbatim.


Duhet theksuar se në të gjithë territorin e marrë në studim ka aktivitete me karakter të njëjtte me ato të marrë në studim. Ky projekt për ligj statusin e kësaj zone në **Bashkinë Kelcyre**.

Në këtë zonë vihet re një sistem rrugor i mirefillte. Qarkullimi, hyrjet e daljet në aktivitet bëhen nëpërmjet **Rruges Tepelene-Kelcyre** që kalon pranë projektit.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bazuar në zhvillim strategjik të

Bashkisë Kelcyre dhe përfshin planifikimin, rehabilitimin dhe masat zbutëse të ndikimit të projektit në këtë zonë.

Do të paraqesim gjendjen e ndikimit të këtij projekti mbi mjedisin e zonës dhe shëndetin e njerezve, do të shqyrtojmë faktorët pozitivë dhe negativë mjedisor, do të paraqesim skemat e rehabilitimit dhe masat zbutëse dhe reduktimin e impakteve negative.



2. INFORMACION PËR QËLLIMIN E RAPORTIT PARAPRAK TE VNM & METODIKËN E ZBATUAR

Gjëndja e mjedisit dhe përkujdesjet ndaj tij, janë ndër problemet dhe sfidat më të mëdha të njerezimit sot. Zhvillimi ekonomik i cili po shoqerohet me rritje të vazhdueshme të numërit të ndërmarjeve operuese, si rrjedhë ka edhe rritjen e ndikimit në mjedis. Ky zhvillim nuk mund të jetë i qëndrueshëm nëse nuk parashikon hapsira për mbrojtjen e mjedisit. Varësisht prej veprimitarisë, ndikimi i operatorëve ekonomik është i shprehur në të gjithë përbërësit e mjedisit, si në ajër, ujë dhe tokë.

Mbrojtja e mjedisit si një sistem dinamik që ndryshon herë pas here fizikisht dhe biologjikisht, i duhen analizuar jo vetëm faktorët natyror, por edhe aktiviteti njerezor i cili lidhet me to. Studimet dhe ndërtimet kur nuk menaxhohen konform ligjeve dhe rregullave të natyrës, ato mund të prishin ekuilibrin e natyrës përreth.

Planifikimi urban si një veprimtari komplekse, natyrore, inxhinjrike, klimatike, biologjike, sociale dhe legislative e shoqerisë njerezore të civilizuar, mbështetet në radhë të parë mbi mjedisin gjeologjik dhe ekosistemet e lidhur me të.

Ai ka dy aspekte veprimitarish:

Së pari, ndryshimet që njeriu i bën gjeomjedisit dhe ekosistemeve për ti pershtatur ato me kërkesat e tij jetësore, sipas filozofise "njeriu e ndryshon natyren" për të përmirësuar jetesën e tij.

Së dyti, impaktet e këtyre ndryshimeve mbi vetë mjedisin gjeologjik si dhe mbi jetën e njerëzve.

Për të realizuar planifikimin urban dhe për të vlerësuar impaktet mbi gjeosistemin, janë të domosdoshme njohuritë mbi gjeomjedisin dhe ndryshimet që ai pëson me kohën. Këto njohuri nxirren nga vrojtme komplekse gjeologjike, gjeofizike, gjeokimike dhe hidrogjeologjike .

Qëllimi i këtij Raporti bazohet në planifikimin e territorit që i është nënshtruar zona, me qëllim zhvillimin e Projektit dhe masat parandaluese qe ka marre Subjekti per Projektin " **Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore** ".

2.1 PËRSHKRIMI I QËLLIMIT TE PROJEKTIT

Raporti Paraparak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është hartuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Qëllimi i këtij Raporti Paraparak të VNM është të vlerësojë impaktet potenciale sociale dhe mjedisore nga implementimi i këtij projekti, të rekomandojë masat zbutëse për minimizimin e impakteve potenciale të vlerësuara, gjatë fazës së funksionimit, duke synuar qëllimin final mbrojtjen e cilësisë së mjedisit.

Raporti Paraparak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis është bazuar në rëndësinë e hartimit të studimeve rajonale mjedisore me standarde bashkëkohore, për përmbushjen e kërkesave të investitorit për projektin, pasurite natyrore dhe humane të zonës në studim, si dhe vlerat e vecanta të tyre.

Identifikimi i efekteve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke pasur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit, masat orientuese dhe shfrytëzimi racional i burimeve natyrore si dhe bashkërendimi i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të zonës me kërkesat e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në Ligjin Nr.10448 datë 14.7.2011 dhe në mbështetje të nenëve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës "Për Lejet e Mjedisit" theksohet në mënyrë të qartë se cilat projekte dhe aktivitete i nënshtrohen për leje mjedisore dhe që jepen në shtojcën 1 dhe 2 të këtij ligji, përpara miratimit të tyre nga organet përkatëse".

Mbështetur në udhëzimin Nr. 4 datë 15.04.2013, si dhe nga konsultimet e bëra në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit, arrijme në konkluzionin se:

"Ky projekt i marrë në vlerësim do t'i nënshtrohet një Raporti për aktivitetin "**Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujrave nentoksore**"

Ky Raport Paraparak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis ka si synim kryesor:

"Vlerësimin e përgjithshëm, të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore, të projekteve që do të zbatohen duke parandaluar dhe zbutur ndikimet negative në mjedis me qëllim mbrojtjen e mjedisit nga ndotja".

Dihet si çdo projekt, edhe ky projekt "**Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujrave nentoksore**" në realizimin e tij ka ndikime në mjedis që lidhen me cilësitë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut "Mbrotja e mjedisit nga ndotja dhe demtimi përben përparësi kombëtare dhe është e detyrueshme për të gjitha organet shtetërore, personave fizike dhe juridike, vendas dhe të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë".



Ortofotote vendodhjes se projektit

Me poshte po japim kordinatat e vendodhjes se projektit.

Pika 1

Veriu X = 40°17'51,97"

Lindje Y = 20°09'19,69"

Pika 2

Veriu X = 40°17'50,68"

Lindje Y = 20°09'25,94"

Pika 3

Veriu X = 40°17'49,43"

Lindje Y = 20°09'19,17"

Pika 4

Veriu X = 40°17'49,16"

Lindje Y = 20°09'25,53"

**Zona ku zhvillon aktivitetin Projekti ndodhet ne Gryka e Kelcyres, Zona Turistike,
Rruga Tepelene-Kelcyre, Kelcyre.**




FIGURA Nr.2 HARTA TOPOGRAFIKE RAJONI KALLMET

Ky Raport percakton nje menyre zhvillimi te kesaj zone duke percaktuar disa kritere parimore mbi zonimin,ku do te zhvillohet projekti. Trualli ne te cilen eshte ndertuar objekti qe zhvillohet aktiviteti, eshte prone private e Shoqerise "TREBESHINA L t.d ". Ky objekt shtrihet ne nje terren te rrafshet ndersa prona eshte e karakterizuar nga nje siperfaqe uniforme ku efekti i erozionit nuk eshte i ndjeshem.

2.2 OBJEKTIVAT E RAPORTIT PARAPRAK TE VNM JANË:

Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis (VNM) ka siguruar nje mbledhje te dhenave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e Projektit, perfshire kushtet fizike, atmosferike, burimet ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social ekonomike te zones. Ne hartimin e studimit perdoret informacioni, te dhenat ekzistuese dhe te pritura referuar kushteve te zones, se bashku me standardet dhe normat e aplikueshme per te vleresuar ndikimet potenciale mjedisore, specifike dhe sociale te fasiliteve te propozuara. Ndikimet potenciale mjedisore te shqyrtuara dhe analizuara ne kete Raport Paraparak te VNM, perfshijne ndikimet ndaj cilesise se ujit, burimeve nentokesore ujore, situates social-ekonomike, kulturore gjate zhvillimit te projektit dhe te aktiviteve lokale te pritura.

Burimet e vleresuar social-kulturore perfshijne punesimin, perdorimin e tokes, transportin dhe sherbimet e komunitetit te zones. Raporti Paraparak VNM percakton masat zbutese per te parandaluar ose minimizuar gjate aplikimit te ndikimeve mjedisore dhe sociale te projektit te propozuar. Keto raportohen ne detaje ne planin e menaxhimit te mjedisit, i cili eshte pjese e studimit. Vleresimi i ndikimit ne mjedis perbehet nga teresia e procedurave te veprimit, monitorimit, zbutjes dhe masave institucionale, qe do te zbatohen gjate Projektit per te eliminuar, kompensuar apo pakesuar ndikimet e kunderta potenciale mjedisore dhe sociale.

Raporti Paraparak VNM trajton menaxhimin specifik te mjedisit, planet monitoruese, identifikon çdo kerkese dhe afatet e duhura te domosdoshme, si me poshte:

- Zona ku ndodhet Projekti, satusi i tij, pershkrimi i vendit dhe mjedisit te tij.
- Kuadri ligjor i politikave dhe planeve per zhvillimin ekonomik te zones.
- Arsyet qe ndikuan ne perzgjedhjen e ketij vendi per kryerjen kesaj veprimtarie.
- Pershkrimi, detajimi dhe trajtimi i disa operacioneve ditore te projektit qe do te zhvillohet, ne raport me situaten mjedisore.
- Identifikimi i ndikimeve me te mundshme mjedisore qe mund te ndodhin ne mjedis nga zhyvillimi i aktivitetit dhe vleresimi i mases se tyre.
- Plani i menaxhimit te mjedisit dhe percaktimi i masave per zbutjen dhe reduktimin e ndikimeve me te mundshme negative.

Qellimi i Raportit Paraparak te Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis (VNM)

I percaktuar me fjale te thjeshta, Raporti paraparak i VNM eshte nje proces per te percaktuar dhe vleresuar efektet apo ndikimet ne mjedis te nje veprimi apo projekti te caktuar.

Ne nje situate normale, ky proces aplikohet perpara se te merren vendimit dhe te fillojne angazhimet per realizimin e projektit. Po sidoqofte, dhe ne çdo kohe, efektet sociale, kulturore dhe shendetesore jane konsideruar si pjese integrale e Raportit Paraparak te VNM. Kujdesi veçante i kushtohet praktikave te VNM per te parandaluar dhe minimizuar efektet emundshme negative te veprimeve te ndermarra.

Qellimi i VNM eshte te:

- Te jape informacion per vendimmarresit per pasojat mjedisore te veprimeve te propozuara.
- Te promovojë zhvillimin miqesor dhe te qendrueshem me mjedisin duke identifikuar masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis.

Zhvillimi i Qendrueshem eshte nje koncept kyç qe ka marre nje perhapje dhe pranim nderkombetar gjate dy dekadave te fundit. Agjenda 21, dhe plani global per zhvillimin e qendrueshem, theksojne rendesine e vendimarrjes se integruar te mjedisit dhe te zhvillimit dhe promovimin e VNM dhe instrumenteve dhe politikave te tjera per kete qellim.

Rendesia e Raportit Paraprak te VNM

Reduktimi i ndikimeve ne mjedis arrihet nese nje zhvillim behet i qendrueshem me mjedisin. Keto ndikime jane mjaft komplekse, me te medha ne shkalle dhe per me teper shtrijne pasojat e tyre me shume se 10 vjet me pare ku u fut koncepti i VNM ne vendin tone. Si rezultat, VNM eshte kthyer ne nje vegjel kyç per vendimarrjen nje nje zhvillim te propozuar.

Ne aspektin nderkombetar, roli i VNM eshte njohur ne Principin e 17 te Deklarates per mjedisin dhe Zhvillimin.

VNM, si nje instrument kombetar duhet te aplikohet per aktivitetet e propozuara te cilat pritet qe te kene ndikim negativ ne mjedis dhe jane subjekt i nje vendimarrje te nje autoriteti kombetar.

Objektivat afatshkurter dhe te drejtperdrejte te VNM:

- Permiresim nga pikepamja mjedisore i propozimit dhe projektit.
- Siguron qe burimet natyrore jane perdorur ne menyren e duhur dhe me efijence.
- Identifikon masat e duhura per zvogelimin e ndikimeve te mundshme potenciale te projektit apo propozimit.
- Lehteson informimin e vendimmarresit, duke perfshire vendosjete termave dhe kushteve mjedisore per zbatimin e projektit apo propozimit.
- Të japë informacion mbi vendndodhjen e projektit dhe të analizojë tiparet mjedisore;
- Të japë informacion mbi projektin teknik, implementimin, marrjen e rezultateve të projektit.
- Të vlerësojë ndikimet e mundshme në mjedisin përreth dhe në banorët e zonës për zhvillimin e aktivitetit.
- Të përshkruajë masat për reduktimin apo evitimin e impakteve të analizuara;
- Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
- Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;

- Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
- Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
- Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
- Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
- Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- Siguron dhe mbron shendetin e njeriut.
- Parashikon dhe perjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe demtimet serioze te mjedisit
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, pesiazhet e natyres dhe komponentet perberes te ekosistemeve.
- Permiroson aspektet sociale te projektit.

Ndikimet mjedisore të projektit do të vlerësohen në lidhje me gjendjen e mjedisit në territorin e implementimit të këtij projekti.

2.3 PËRSHKRIM I PËRMBLEDHUR I KUADRIT LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL QË LIDHET ME PROJEKTIN

Kuadri ligjor për Mbrojtjen e Mjedisit në Republikën e Shqipërisë është në përputhje me standardet e BE-së.

Gjatë dhjetë vjeçarit të fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore mjedisore, si rezultat i degradimit mjedisor të vendit gjatë zhvillimit industrial që mori vëndi në vitet 50-të.

Politikat e përpiluara për mjedisin në ditët e sotme janë pasqyruar në Aktet Ligjore dhe Nënligjore të Mjedisit gjatë 2000 – 2015, si dhë në disa ligje e VKM të miratuara më vonë se këto vite.

Investitori **Shoqeria "TREBESHINA L t.d" Sh.p.k.** pasi është pajisur me dokumentacionin e plotë në lidhje me pronësitë dhe ndertimin ku është projektuar ndertimi kërkon që të paiset me leje Mjedisore për Aktivitetin "**Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore**". Me kërkesë të vet Shoqerise është kërkuar që për këtë Projekt të bëhet një Vlerësim Mjedisor në veçanti, për vet ndjeshmërinë, që mund të ketë implementimi i këtij projekti në komunitet dhe mjedisin e zonës përreth.

Klasifikimi i projektit: Në bazë të ligjit nr.10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca II Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, ky aktivitet përshihet në **piken 10.h "Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore"**.

Vendimi i VNM Paraprake është dokumenti i përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe e firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, bazuar në Ligjin Nr.10 081, datë 23.2.2009.

"PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË".

Metodologjia e hartimit të VNM është hartuar në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës mjedisor të shprehura në Udhëzimin Nr.3, datë 19.11.2009 "Për Metodologjinë e Vlerësimit të Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis". Vlerësimi i ndikimeve në mjedis në zonën e projektit merr në konsideratë se si keto procese gjatë zbatimit të projektit ndikojnë në gjëndjen ekzistuese të mjedisit të zonës dhe më vonë. Ndikimet akumulative që mund të ndodhin mund të shfaqen menjëherë kur ndodh një ndërhyrje në mjedis apo shfaqen në mënyre indirekte dhe ato mund të shfaqin shkallë të ndryshme rëndësie. Këto ndikime mund të jenë të ndryshme në kohë zgjatjen e ndikimit (Afatshkurtër, Afatmesëm dhe Afatgjatë në kohë) dhe të ndryshme në karakterin e tyre (ndikim i përkohshëm dhe i përhershëm).

Hartimi i këtij Raporti Paraprak të VNM-je është bërë në përputhje me ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" ku sipas nenit 8 të këtij ligji, përcaktohen edhe projektet që i nënshtrohen procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, sipas shtojcës II i nënshtrohen Procedurës Paraprake të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

Gjithashtu hartimi i këtij raporti paraprak të vlerësimit të ndikimit në mjedis është bërë në përputhje me ligjin Nr.10 431, datë 9.6.2011 "Per Mbrojtjen e Mjedisit", i cili është përafuar plotësisht me Direktivën 2004/35/KE të Parlamentit European dhe Këshillit, datë 21 prill 2004

"Mbi përgjegjësinë mjedisore, parandalimin dhe riparimin e dëmeve mbi ambientin"

Hapat e ndjekura për përgatitjen e raportit nga **Eksperti i Mjedisit** janë bazuar në Kreun I "Zhvillimi i Procedurës Paraprake të Vlersimit të Ndikimit në Mjedis" të Vendimit Nr. 13, datë 4.1.2013 "Për Miratimin e Rregullave, Të Përgjegjësisë e Të Afateve Për Zhvillimin e Procedurës së Vlersimit të Ndikimit Në Mjedis"

2.4 LEGJISLACIONI KRYESOR SHQIPTAR PËR HARTIMIN DHE KLASIFIKIMIN E RAPORTIT TË VNM-SË:

Ligji nr. 10440 datë 07.07.2011 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"

Ky ligj ka për qëllim të sigurojë:

- a) Një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, përmes parandalimit, minimizimit dhe kompensimit të dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara që përpara miratimit të tyre për zhvillim;
- b) Garantim i një procesi të hapur vendimmarrjeje, gjatë identifikimit, përshkrimit dhe vlerësimin të ndikimeve negative në mjedis, në mënyrën dhe kohën e duhur, si dhe përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në të.

Projektet që i nënshtrohen procedurës paraprake të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis sipas Kreut II, nenit 8 të këtij ligji, citojmë:

1. Procedurës paraprake të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis i nënshtrohen:
 - a) Projektet e listuara në Shtojcën II;

Në mbështetje të ligjit nr.10440 "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis"nenit 10, pika "a" citojmë:
Paraqitja e kërkesës për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, pranë QKL-së nga zhvilluesi.

Për projektet e Shtojcës II:

1. Raportin paraprak të VNM-së.
2. Projektin teknik të veprimtarisë
3. Fatura e pagesës së tarifës së shërbimit

Përmbajtja e Raportit Paraprak të Vlerësimin të Ndikimit në Mjedis është përcaktuar në Shtojcën I të VKM nr.13, datë 4.1.2013 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësisve e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimin të ndikimit në mjedis".

Ligji nr.10431 datë 10.03.2011 "Për Mbrojtjen e Mjedisit". Ky ligj ka për qëllim mbrojtjen e mjedisit në një nivel të lartë, ruajtjen dhe përmirësimin e tij, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Në bazë të këtij ligji, neni 3 i tij, citojmë objektivat e mbrojtjes së mjedisit:

- a. parandalimi, kontrolli dhe ulja e ndotjes së ujit, ajrit, tokës dhe ndotjeve të tjera të çdolloji;
- b. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i natyrës dhe i biodiversitetit;
- c. ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i qëndrueshmërisë mjedisore me pjesëmarrje publike;
- d. përdorimi i matur dhe racional i natyrës dhe i burimeve të saj;
- e. ruajtja dhe rehabilitimi i vlerave kulturore dhe estetike të peizazhit natyror;
- f. mbrojtja dhe përmirësimi i kushteve të mjedisit.

Parimet e mbështetura në Kreun II të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit":

- parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- parimi i kujdesit
- parimi i parandalimit
- parimi "ndotësi paguan"
- parimi i riparimit të dëmeve mjedisore, përtëritjes e riaftësimit të mjedisit të dëmtuar
- parimi i përgjegjësisë ligjore
- parimi i mbrojtjes në shkallë të lartë
- parimi i integritetit të mbrojtjes së mjedisit në politikat sektoriale
- parimi i ndërgjegjësimit dhe i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrjen mjedisore
- parimi i transparencës në vendimmarrjen mjedisore.

"Zhvillimi i qëndrueshëm" i cili është zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes dhe të se ardhmes pa shtrënguar ose prekur mundësitë dhe kapacitetet që edhe brezat e ardhshëm të plotësojnë nevojat e tyre.

"Përdorimi i qëndrueshëm" i burimeve natyrore e minerare i cili siguron plotësimin e nevojave të sotme, pa cënuar nevojat e brezave të ardhshëm për këto burime.

"Teknikat me te mira te mundshme" përfaqësojnë fazën me te përparuar dhe me nivel te larte te mbrojtjes se mjedisit, te zhvillimit te një veprimtarie dhe qe janë plotësisht te zbatueshme nga pikëpamja praktike dhe ekonomike.

"Parimi i parandalimit" është përzgjedhja dhe miratimi i variantit më të mirë, që në fazën fillestare të vendimmarrjes, për të shmangur ndikime të dëmshme të një veprimtarie në mjedis.

"Parimi i riaftësimit" është domosdoshmëria për të riparuar dëmet mjedisore të shkaktuara nga vetë personat fizikë e juridikë dhe për te përtëritur dhe riaftësuar mjedisin e dëmtuar .

"Parimi "Ndotësi paguan"" nënkupton koston që paguan ndotësi për përmirësimin e një mjedisi të ndotur dhe për kthimin e tij në një gjendje të pranueshme. Kjo pasqyrohet në koston e prodhimit, të konsumit të mallrave dhe të shërbimeve që shkaktojnë ndotjen.

2.5 PËRMBLEDHJA E KUADRIT LIGJOR DHE INSTITUCIONAL

Gjate njezetvjeçarit te fundit qeveria ka realizuar zhvillimin e akteve ligjore Mjedisore, si rezultat i ndryshimeve degraduese mjedisore te cilat kane ardhur si rezultat i industris para viteve 90-te dhe zhvillimeve te fundit. Ligjet e perpiluara per Mjedisin ne ditet e sotme jane pasqyruar ne Aktet Ligjore Mjedisore 1991-2013.

Menaxhimi dhe mbrotja e mjedisit jane pjese e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se: "Shteti, brenda kompetencave Kushtetuese dhe mjeteve qe disponon, si dhe ne plotesimin e nismes dhe te pergjegjesise private, synon:

Nje mjedis te shendetshem dhe ekologjikisht te pershtatshem per brezat e sotem dhe te ardhshem.

Legjislacioni mjedisor është ndërtuar për të mbrojtur dhe parandaluar komponentë të veçantë dhe të rëndësishëm të mjedisit.

Kështu, ndër më specifiket përmendim:

Tabela 1 Legjislacioni mjedisor

Baza Ligjore	
Ligji Nr.10 431 datë 9.6.2011	Për mbrojtjen e Mjedisit
Ligji Nr. 10440, datë 07.07.2011	Për vlerësimin e ndikimit në mjedis
Ligji Nr. 10448, datë 14.07.2011	Për lejet e mjedisit
Ligji Nr.9362, datë 24.03.2005	Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve
Ligji Nr.8897, datë 16.05.2002	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr.9587, datë 20.07.2006	Për mbrojtjen e biodiversitetit
Ligji Nr.8906, datë 6.6.2002	Për zonat e mbrojtura I ndryshuar me: - Ligjin Nr.9868, datë 04.02.2008
Ligji Nr.10081, datë 23.02.2009	Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë
Ligji Nr.7875, datë 23.11.1994	Për mbrojtjen e faunës së egër dhe gjuetinë" I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9219 datë 08.04.2004
Ligji Nr.9385, datë 04.05.2005	Për pyjet dhe shërbimin pyjor", I ndryshuar me: Ligjin Nr. 9791 datë 23.07.2007
Ligji nr. 8770, datë. 19.04.2001	Për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike i azhornuar
Ligji Nr. 9774, datë 12.07.2007	Për administrimin e zhurmës në mjedis
Ligji Nr. 8766, datë 05.04.2001	Për mbrojtjen nga zjarri dhe për shpëtimin
Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001	Për emergjencat civile
Ligji Nr. 7643, 09.12.1999	Për Inspektoratin Sanitar Shtetëror

RAPORT PARAPRAK I VNM "NXERRJA E UJIT NENTOKSOR DHE SKEMAT E TJERA PER RIMBUSHJEN ARTIFICIALE
TE UJRAVE NENTOKSORE"

I ndryshuar	
Ligji Nr.9379, datë 28.04.2005	Për eficiencyn e energjisë
Ligji Nr. 9010 datë 13.02.2003	Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta I ndryshuar me :Ligjin Nr.10 137, datë 11.05.2009
Në Parlamentin e Republikës së Shqipërisë janë miratuar edhe disa ligje në kuadër të përfshirjes së vendit tonë në Protokolle dhe Marrëveshje të ndryshme. Ndër to përmendim:	
Ligji Nr. 9672, datë 26.10.2000	Për ratifikimin e konventës së Aarhusit "Për të drejtën e publikut për të pasur informacion dhe përfshirjen në vendimmarrje, si dhe për t'iu drejtuar gjykatës për çështjet e mjedisit".
Ligji Nr. 9334, datë 16.12.2004	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin e Kiotos në konventën për ndryshimet klimatike (UNFC).
Vendime të Këshillit të Ministrave	
VKM Nr. 13, datë 4.01.2013	Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis.
V.K.M Nr. 395, datë 21.6.2006	"Për miratimin e strategjisë dhe të planit të veprimit për zhvillimin e turizmit, kulturor dhe mjedisor
VKM Nr.123, datë 17.2.2011	Për miratimin e planit kombëtar të veprimit për menaxhimin e zhurmave në mjedis.
VKM Nr. 587, datë 7.07.2010	Për monitorimin dhe kontrollin e nivelit të zhurmave në qendrat urbane dhe turistike.
VKM Nr. 676, datë 20.12.2002	Për shpalljen e zonave të mbrojtura monument natyror
VKM Nr.804, datë 4.11.2003	Për miratimin e listës së specieve të florës shqiptare që vihen në mbrojtje.
VKM Nr. 177, datë 31.3.2005	Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngëta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse.
VKM Nr.435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve në ajër në Republikën e Shqipërisë.
VKM Nr.803, datë 4.12.2003	Për standardet e cilësisë së ajrit.
VKM Nr.247, datë 30.04.2014	Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen

	mjedisore
VKM Nr.114, datë 27.01.2009	Për marrjen e masave emergjente, për përmirësimin e situatës së sigurisë dhe të veprimtarive në instalimet, që shërbejnë për depozitimin transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre.
VKM Nr.686, datë 29.07.2015	Per miratimin e rregullave te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e proceduresse vleresimit te ndikimit ne mjedis dhe procedures se transferimit te vendimit e deklarates mjedisore.
Udhëzime dhe Rregullore	
Udhëzimi Nr. 1037/1, datë 12.04.2011	Për vlerësimin dhe menaxhimin e zhurmës mjedisore
Udhëzimi Nr. 8, datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedis të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527, datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe mënyrat e kontrollit të tyre.
Rregullore	
Rregullorja Higjeno-Sanitare datë.17.11.1997	Për pastrimin në zona urbane dhe rurale, administrimin dhe trajtimin e mbeturinave
Rregullore, Nr.1, datë 30.03.2007	Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre

Kuadri Ligjor Nderkombetar

Shqipëria është një vënd i cili është tashmë nënshkrues i shumë konvetave dhe marrëveshjeve mjedisore dhe kjo ka ndihmuar në nxitjen e hartimit të ligjeve kombëtare mjedisore në përputhje me praktikat ndërkombëtare. Ky raport duhet të përshtatet me ligjet dhe aktet ligjore në nivel lokal dhe ato kombëtare dhe më poshtë ilustrohen në mënyrë të përmbledhur etapat kryesore të zhvillimit të politikës europiane në fushën e mjedisit.

- Protokollin e Kievit: Për vlerësimin strategjik mjedisor. Ratifikuar në vitin 2005
- Protokollin e Kartagjens: Per biosigurine. Berë pale ne vitin 2005

- Konventa e Stockholmit: Mbi ndotësit organike të qëndrueshem. Ligji nr. 9263, datë 29.07.2004
- Protokollin e Kartagjens: Për sigurinë biologjike. Ratifikuar në vitin 2004.
- Ligji nr. 9279, datë 23.09.2004
- Konventa e Ëashingtonit: Për trejetinë ndërkombetare të llojeve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër. Ligji nr. 9021, datë 06.03.2003.

Kuadri Ligjor European

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përfaqë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujrave.
- Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) "Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën".
- Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave të Planeve dhe Programeve të Caktuara mbi Mjedisin.
- Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pb në ajër.
- Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 për cilësinë e ujrave të embla
- Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.
- Direktiva 91/689/CE Për Mbetjet e Rrezikshme.

Konventat Ndërkombëtare

Brenda dekadës së fundit, Shqipëria është bërë shumë aktive në fushën e mjedisit dhe ka firmosur shumë konventa dhe protokolle ku mund të përmendim disa prej tyre:

- Konventën e Aarhus për akses në informacion, pjesëmarrje të publikut në vendim marrje ambjentaliste dhe akses të drejtësisë në çështjet ambjentaliste, të ratifikuar me Ligjin Nr. 8672, datë 26 tetor 2000,
- Konventën e Rio De Janeiro-s për Biodiversitetin, të ratifikuar me 10 Nentor 1996,

- Konventa per Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis në kontekstin ndërkufitar ESPOO, Finlandë, me 25 shkurt 1991
- Konventa mbi Ndotjen Atmosferike në distanca të mëdha, Gjenevë, Zvicër, me 13 nëntor 1979.
- Konventa për Ruajtjen e Florës dhe Faunes së egër dhe mjedisit natyror të Europës Ne Bernë, 19 shtator 1979
- Konventa Ndërkombëtare Detare "Për Parandalimin E Ndotjeve Nga Anijet, 1973", Të Ndryshuar Me Protokollin E Vitit 1978 (Marpol 73/78) ratifikuar nga RSH me Ligjin Nr.9594, datë 27.7.2006;
- Konventa Ndërkombëtare Detare "Për Përgatitjen Ndaj Ndotjes Nga Nafta, Reagimi Dhe Bashkëveprimi (Oprc), 1990" Ratifikuar Nga RSh Me Ligjin Nr.9692, Datë 8.3.2007;
- Konventën Ndërkombëtare "Për Përgjegjësinë Civile për Dëmet nga Ndotjet me Karburant", 1992, Ratifikuar nga RSH me Ligj Nr.9293, datë 21.10.2004;

Referimet në nivel komunitar në fushën e menaxhimit të mbeturinave janë të shumta dhe për qëllimet tona është e dobishme të përzgjidhen ato më kryesoret.

Disa nga parimet themelore, parimet bazë, që sugjerojnë linjat e veprimit dhe objektivat që përmbajnë programet komunitare, po i pershkruajme më poshtë.

2.6 PËRSHKRIM TË METODIKES TË ZBATUAR PËR HARTIMIN E RAPORTIT PARAPRAK TË VNM-SË

Metodologjia e VNM-së i referohet çështjeve mjedisore të sugjeruara nga objektivat e parashtruara në Kushtet e Referencës. Raporti i Mjedisit është përgatitur siç detajohet në ligjin përkatës. Për më tepër, raporti rrespekton edhe legjislacionin e BE dhe sigurisht atë Shqipëtar, siç kërkohet. Raporti është përgatitur në bazë të metodave shkencore të themeluara dhe pranura gjerësisht të cilat përdoren për përgatitjen e vlerësimeve të tilla.

Metodat e mbledhjes së të dhënave janë të përshkruara në kapitujt e mëposhtëm të këtij raporti. Të dhënat janë mbledhur kryesisht nga inspektimet në terren në zonën e zhvillimit të projektit në **Shtator-Tetor 2015** nga një ekip inpektorësh dhe eksperti i mjedisit në bashkpunim me inxhinierin projektues. Megjithatë, të dhëna të publikuara më parë dhe literatura në dispozicion nga projekte të ngjashme janë referencuar gjatë përgatitjes së këtij raporti të VNM-së.

Studimi i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis, u orientua nga rëndësia e veçantë që paraqet "**Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore**", me qëllim konsolidimin strukturor dhe përshtatjen sizmike të godinës si dhe realizimin e ndërteses me lidhje të fortë funksionale, gjithashtu janë marre në konsideratë edhe pasuritë natyrore dhe humane të zonës, si dhe vlerat e veçanta të tyre, identifikimi i ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse,

duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese për një zhvillim të qëndrueshëm.

Në këtë raport, identifikohen ndikimet pozitive dhe negative në natyrë dhe në mjediset humane, si dhe është marrë parasysh dhe vlerësimi i rrezikut. Reduktimi i ndikimeve negative, është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive të cilat strukturohen në katër faza kryesore:

1. Ngritja e objektivave orientuese të Raportit të VNM;
2. Mbledhja e materialit bazë ekzistues dhe plotësimi i formularit përkatës për këtë raport si dhe seleksionimi i tyre për përdorim;
3. Verifikimi në terren i të dhënave ekzistuese dhe mbledhja e të dhënave të mundshme;
4. Hartimi i VNM dhe dorëzimi për marrjen e Vendimit Paraprak të VNM-së, si dhe subjektet vendim-marrëse dhe kontrolluese të aspekteve mjedisore, në nivele lokale.

Nga Institucionet e specializuara, sipas porosisë së AKM/MM, mund të kryhen monitorimet si më poshtë:

- Monitorimi i zhurmave nga specialistët e kësaj fushe pranë Inspektoriateve përkatëse;
- Monitorimi i punimeve, nga pikpamja e karakteristikave fizike, kimike e ndotesit potencialë, gjithçka në normat dhe standartet ndërkombëtare në mënyrë që ai të shërbejë realisht për performancën e lartë e shëndetit publik;
- Monitorimet mbi biodiversitetin, do të fillojnë pas fillimit të masave rehabilituese dhe me kohë do të vendoset fokusi dhe hapësirat e zhvillimit të tyre.

Shoqëria do të mirëpresë, ndihmojë dhe lehtësojë, çdo iniciativë monitoruese mjedisore, që do t'i këshillohet në "Vendimin Paraprak të VNM-së", në shërbim të së cilës është kryer edhe ky raport. Gjithashtu, inspektimet nga specialistët e autorizuar të shëndetit publik dhe mjedisit do të mbështeten në çdo kohë nga kjo shoqëri, për realizimin e auditimeve mjedisore dhe shëndetësore.

Raporti i VNM-së përfshin të dhënat e mëposhtme në përputhje me udhëzimin Shqiptar mbi VNM:

- Fushëveprimi i projektit, data e supozuar e fillimit
- Përshkrimi i zonës së projektit shoqëruar me një hartë dhe fotot e objektit
- Përshkrimi i proceseve teknologjike
- Lloji, vëllimi, konsumi dhe prodhimi i materialeve të papërpunuara
- Informacion të detajuar në lidhje me shkarkimet në mjedis
- Informacion në lidhje me cilësinë e ajrit dhe ujërave sipërfaqësore në zonën e projektit ku do të zhvillohet shkarkimi në mjedis.

- Informacion në lidhje me lokacionet ku do të ndodhin shkarkimet
- Rreziqet e mundshme për mjedisin dhe nevojën për të shmangur dhe minimizuar ndikimin e tyre në mjedis
- Masat zbutëse për kapjen dhe trajtimin e shkarkimeve në mjedisit dhe të ndotjes
- Një program për monitorimin e shkarkimeve në mjedis
- Nje plan për menaxhimin e mbetjeve

2.7 METODIKAT E ZBATUARA DHE MËNYRA E SIGURIMIT TË INFORMACIONIT

Metodika e zbatuar për përpilimin e strukturës së raportit të VNM-së është bazuar në kërkesat e VKM Nr. 13 Datë 4.01.2013, Shtojca I.

Hapat e ndjekur për hartimin e raportit të VNM-së:

Hapi 1	Njohja me projektin teknik
Hapi 2	Konsultimi me kuadrin ligjor
Hapi 3	Rishikim i gjendjes aktuale mjedisore, për të evidentuar ndryshimet e mundshme, evulimet apo përmirësimet e saj nëpërmjet inspektimeve në terren
Hapi 4	Evidentimi i impakteve negative të mundshme gjatë zhvillimit të projektit
Hapi 5	Evidentimi i impakteve kumulative të mundshme nga aktivitetet e tjera që kryhen aktualisht në rajonin e projektit
Hapi 6	Hartimi i masave për zbutjen e impakteve në mjedis dhe monitorimin në mjedis
Hapi 7	Konsultimet dhe përfshirja e aktorëve dhe gjithë grupeve të interesit.

Hartuesit e këtij Raporti paraprak të VNM pasi studiuan projektin teknik, i cili do të implementohet dhe prezantohet nëpërmjet këtij raporti, gjetën dhe bënë përputhshmërinë ligjore, kërkesat dhe normat që duhet të zbatohen gjatë zhvillimit të këtij projekti.

Zona ku do të implementohet " **Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujrave nentoksore** ", është një zonë e njohur për hartuesit e këtij raporti, të cilët kanë eksperiencë dhe njohuri të mira për gjendjen aktuale të mjedisit fizik dhe karakteristikave të tjera mjedisore të saj.

Hartuesit e këtij raporti bënë konsultime edhe me specialistët e komunitetit vendas, përfaqësues të komunave për çështje specifike, si dhe për të marrë opinionin e tyre lidhur me projektin. Gjatë hartimit të këtij raporti u bë një analizë e detajuar e të gjithë projektit teknik, për të nxjerrë impaktet e mundshme në mjedis, për të përcaktuar sa të rëndësishme janë këto impakte dhe për të parashikuar kohëzgjatjen dhe kthyeshmërinë ose jo të tyre.

Lidhur me këtë, grupi hartues i Raportit Paraparak te VNM-së, u bazua edhe në literaturën bashkëkohore, në vende analoge ku aplikohen këto projekte. U morën në konsideratë praktikatat më të mira të punës edhe gjatë hartimit të masave parandaluese, zbutëse dhe rehabilituese të impakteve të evidentuara.

Krahas komunikimeve të vazhdueshme me kompaninë zhvilluese për marrjen e informacioneve mbi projektin, grupi i hartimit të Raportit paraparak te VNM-së ka shfrytëzuar informacione nga website të ndryshme si dhe literatura.

Gjatë hartimit të këtij Raporti Paraparak te VNM, është garantuar një proces i hapur konsultimesh me të gjithë aktorët dhe grupet e interesit të cilët janë përfshirë nëpërmjet mundësisë që ju krijua për të dhënë mendimet dhe sygjerimet e tyre.

3. PERSHKRIMI I MBULESES BIMORE TE SIPERFAQES KU ZHVILLOHET PROJEKTI

3.1. Zonat e mbrojtura


Në afërsi të këtij rajoni ku zhvillohet e aktivitetit nuk ka ndonjë zonë të mbrojtur.

Statusi i zones

Territori ku zhvillohet aktiviteti nuk është i përfshirë në mënyrë të drejtperdrejte si zone e mbrojtur si:

- a) rezerve strikte natyrore\ rezervat shkencor\ (Kategoria I);
- b) park kombetar (Kategoria II);
- c) monument natyror (kategoria III);
- ç) rezervat natyror i menaxhuar\ zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (Kategoria(IV));
- d) peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- dh) zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara\ zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte (Kategoria VI).

Zona ku do zhvilloje projektin " **TREBESHINA L t.d.** " **Sh.p.k.** nuk është i përfshirë në zone buferike, të cilat ruhen në përputhje me legjislacionin e Mjedisit në fuqi dhe në përputhje me politikën dhe planet që aplikon Ministria e Mjedisit.



Harta e zonave te mbrojtura.

Kjo zone nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me interes nderkombetar, ku mund te permendim konventen e Ramsarit, konventa boterore e trashgimise, etj.

Raporti identifikon ne menyre te qarte si perfitimet pozitive dhe ato negative dhe percakton "rezultate te pergjithshme" per secilen prej tyre. Raporti Paraprak i Vlersimit te Ndikimit ne Mjedis identifikon nese ndikimet jane mesatare te pranueshme, te rendesishme, te terthorte apo te drejtperdrejta.

3.2. Biodiversiteti

Megjithese Shqipëria është një vend i vogël, ajo është e dalluar për faunën e saj të pasur, tiparet specifike të bimësisë dhe biodiversitetin e lartë. Kjo dukuri shkaktohet nga kushtet specifike ekologjike

të lidhura me pozicionin gjeografik të vendit dhe formimin gjeologjik dhe tokësor. Pavarësisht nga masat e marra, fauna dhe flora kanë qenë nën një presion të madh dhe biodiversiteti i tyre në disa zona ka pësuar humbje. Masat e marra për ruajtjen e specieve të rralla dhe në rrezik zhdukjeje të florës dhe faunës pasqyrohen në një urdhër special të Ministrisë të Bujqësisë dhe Ushqimit të vitit 1997.

Sipas studimeve të Institutit të Kërkimeve Biologjike të kryera në vitet 1997-1998 speciet bimore që vijojnë janë në rrezik zhdukjeje në nivel kombëtar: dafina, çaji i malit, sherebela, trumza, lisi, gjineshtra, borziloku i egër dhe orkidat. Një studim i kryer në 1998 nga Instituti i Kërkimeve të Pyjeve dhe Kullotave ka arritur në konkluzionin se pyjet e plepave të bardhë, të blirit, të dushkut, të mëshhtëknës dhe të verit konsiderohen si specie të rrezikuara në nivel kombëtar.

Sipërfaqja në studim ndodhet në zonën e Kelcyres, territor administrativ i Bashkisë Kelcyre, në Rrethin e Permetit.

Flora.

Zona e Kelcyres bën pjesë në brezin e shkurreve dhe drurrëve mesdhetare ku përmendim pyjet gjethëgjere. Në zonat përreth vazhdojnë të mbijetojnë në pakicë si: makiet, shibjaku (paliurus spinachristi), cermedelli (cotunus coggygria), shqemia (arhus coriaria), shege (punica granatun), gorrica (pyrus amygdaliformis), murrizet, thana, etj. Në këto zona janë mbjellë bimë dekorative (Pinus nigra, picea conica, talus bacceta, juniperus virginiana, etj), një pjesë e mirë e tyre nga kontribues individual nga sektori i biznesit vendas. Sheshi i subjekti është i mbjellur me bimësi dekorative, duke krijuar një peisazh të qetë për zonën dhe punonjësit.

Sipërfaqja bimore karakterizohet nga bimesi barishtore dhe shkurre, nuk karakterizohet nga zone pyjore, si rrjedhojë nuk vlerësohet ndër zonat me vlera të larta të biodiversitetit, të specieve bimore e shtazore.

Për këto zone, nuk disponojmë të dhëna të detajuara rreth biodiversitetit, si rrjedhojë nuk jemi në gjendje të kryejmë një identifikim të saktë të llojeve të specieve që ndodhen në këto biodiversitet.

Tabela Permbledhese e flores dhe faunes se eger (lloji)

Emri	Totali	Te Mbrojtura
Flora,total	3.250	306
Fauna	-	-
Gjitaret	84	80
Zogjte	325	311
Amfibet	15	14
Zvarraniket	37	37
Ikti fauna	313	-
	Insektet	4.000

Sipas studimeve te Institutit te Kerkimeve Biologjike te kryera ne vitet 1997-1998 speciet bimore qe vijojne jane ne rrezik zhdukjeje ne nivel kombetar: dafina, faji i malit, sherbela, trumza, lisi , gjineshtra, borziloku i eger dhe orkidat. Nje studim i kryer ne 1998 nga Institutit i Kerkimeve te Pyjeve dhe Kullotave ka arritur ne konkluzionin se pyjet e plepave te bardhe, te blirit, te dushkut, te meshteknes dhe te verrit konsiderohen si specie ne zhdukje ne nivel kombetar.

Bredhi konsiderohet një nga reliket bimore mesdhetare më të rëndësishëm në vend dhe është një nga parqet më të mëdhenj në Ballkan me Bredh Maqedonas.

Aty përveç bredhit gjen disa lloje panjash, shkozë e zezë, ilqe, dëllinjë e kuqe dhe e zezë, mjedër etj. Në lartësinë 800-1000 metra takohen livadhe e vende të sheshta të rrethuar nga drurë shekullorë të përmasave të mëdha. Gryka e Kelcyres formon një kurorë të gjelbërt gjigande me kontraste të dukshme nga njëra-tjetra.

E gjithë Gryka e Kelcyres dallohet nga mbulesat e dendura vegjetacionit pyjor të cilat kanë pothuajse një shpërndarje të njëjtë në të dy anët e lumit Vjosa. Vëzhgimet tona u fokusuan përgjatë aksit të trazuar të rrugës së kalimit të automjeteve e cila do të degëzohet prej Rrugës auto-rurale që shkon Tepelene-Kelcyre.

Le të përshkruajmë shkurtimisht përbërjen llojore të mbulesave pyjore që gjenden në të dy anët e këtij segmenti duke cituar vlerat e tyre në biodiversitetin natyror nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, rolin madhor që kanë në ruajtjen e tokave nga rrëshqitjet masive, nga gërryerjet dhe shplarjet e tyre prej reshjeve atmosferike.

Gjithashtu do të citojmë edhe shërbimet ekonomike e mjedisore që këto shkurreta japin për komunitetet e kësaj zone malore ashtu si dhe për mbarë komunitetin e rajonit.

Llojet kryesorë shkurrorë që gjenden në pjesmarrjen e mbulesave pyjore janë llojet e njohur të shkurretave tëzonës mesdhetare të cilat përbëhen kryesisht nga llojet: Mare (*Arbutus unedo*), Mrete (*Phyllorea media*), Shkozë e Zezë (*Carpinus orientalis*), Dëllënjë e Kuqe (*Juniperus oxycedrus*), Ilqje (*Quercus ilex*, Cermedell (*Cotinus coggygria*); Bajame e Egër (*Amygdalis eëbii*), Ullastër (*Olea oleaster* var. *sylvestris*); dhe Mëllagjer (*Arbutus andrachnè*).

Ndër llojet e drurëve pyjorë që përhapen masivisht në këtë vënd janë pisha, bredhi, dushqet që përbëhen kryesisht nga llojet: Qarr (*Quercus cerris*), Shparth (*Quercus frainetto*), Bulgër (*Quercus trojana*) etj.

Në vendet e pjerrët ku fenomeni i shplarjes është i dukshëm gjenden të instaluar dy nga llojet tipikë të Mënishteve: *Cistus villosus* dhe *Cistus salviaefolia*. Këta të fundit janë mjaft të rekomanduar për veshjen e skarpateve me toka skeletike që ngrihen mbi gëlqerorët ose atyre që përbëhen nga shiste shtuforë të shpërbërshëm, tokat e të cilëve shplahen ose rrëshqasin në mënyrë të vazhdueshme.

Shërbimet ekonomike e mjedisore që përfitohen nga famijet fermere të fshatrave të zonës kanë të bëjnë me:

- përdorimin tradicional të kontrolluar të lëndës drusore për ndërtime, për ngrohje dhe për gatim familjar;
- Mbarështimin blegtoral tradicional të dhisë e të lopës;
- (iii) ushtrimin e gjuetisë sportive e turistike dhe
- elementët mjedisorë cilësorë për mbarëvajtjen shëndetësore humane si ç'janë burimet e ujërave, ajëri i pastër dhe prodhimet organike bimore e shtazore etj.



Fauna e zones

Zona në studim nuk dallohet për ndonjë botë të pasur shtazore. Si zonë në zhvillim, prania e kafshëve të egra në këtë zonë është shumë e vogël. Zogjtë që karakterizojnë zonat përreth janë si: pëllumbi (*Streptopelia decaoto*), trumcaku (*Troglodytes*), harabela (*passer domesticus*), kumriet, etj. Ndërsa insekte kemi brumbuj, grerëza, milingona, pilivesa, mushkonja, flutura, etj. Nuk vihet re prania e ndonjë specie që është e përfshirë në "Librin e Kuq".

Bota shtazore është e pasur. Nga gjitarët takohen ariu i murrmë, ujku, dhelpra, kunadhja, derri i egër, lepuri i egër, ketri etj. Por krenaria e këtij parku dhe përfaqësuesi tipik i tij është kaprolli, të cilin mund ta shohësh në livadhe dhe lëndina në thellësi të pyllit.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr 102, datë 15 janar të vitit 1996 zona me sipërfaqe 1200 hektarë është shpallur Zone Turistike si Gruka e Kelcyres.

Bredhi është masivi pyjor më i mbrojtur në Shqipëri duke i rezistuar deri tani çdo dëmtimi apo shpyllëzimi nga njeriu.

Kaprolli



Lepuri i eger



Ketri i zones



Dhelprat e zones (Vulpini)



Ujku Gri (Canis lupus)

3.3. Peisazhi

Peizazhi është një vlerë e veçantë për zonën e përshkuar nga shtrati i Lumit të Vjoses.

Përveç vlerave monumentale të natyrës që shprehen me:

- (i) praninë e kanionit të lumit me gjatësi 2 km;
- (ii) Shpellën e pëllumbave etj,

Zona ka gjithashtu një hapësirë të madhe peisazhistike me pyje të dendur dhe me relief të bukur malor që mbart vlera të veçanta jo vetëm për banorët e komuniteteve rrotull por është mjaft atraktive për turistët që vinë periodikisht për të pushuar në periudha të ndryshme të vitit.

Në këtë kontekst, konservimi i aspektit të peisazhit duhet të përbëjë një tjetër objektiv specifik afatgjatë të ndërhyrjeve që duhen mbështetur nga kompania investitore në të ardhmen duke ftuar për bashkëpunim të natyrshëm shoqatën e përdoruesve të pyjeve dhe kullotave në Gryken e Kelcyres si organizatë përfaqësuese legjitime e banorëve të zonës në fjalë.

3.4. Cilësia e Ajrit.

Duhet nënvizuar se nga e kaluara kemi një përmirësim të dukshëm lidhur me cilësinë e ajrit, por jemi akoma larg normave të lejuara nga ato të Bashkimit europian.

Ndotja e ajrit nga trafiku i makinave rezulton të jetë nga:

- Dioksidi i karbonit (CO₂)
- Hidrokarburantet
- Lëndët e imëta (grimcat), përmasa që i referohet është PM10 (këto janë grimca të imëta, më të vogla se 10 mikron).

Ndotja e ajrit ndikon drejtë përdrejtë në jetën dhe shëndetin e njerëzve. Kështu LNP (lëndë të ngryra pezull), nëpërmjet frymëmarrjes ndikojnë për keq në mushkëritë e banorëve. Matjet e realizuara nga ISHP gjatë vitit 2014, në Rrethin e Permetit për cilësinë e ajrit tregojnë se: Përmbajtja e ndotësave të gaztë SO₂ dhe NO₂ janë brenda normave të lejuara të standartit Shqipëtar, madje 3 herë më të ulëta (përkatesisht 20.1 g/m³ dhe 28.1 g/m³, ndërsa norma Shqipëtare është 60 g/m³). Krahasuar me normat e BE (40 g/m³). Vlerat e NO₂ nuk e kalojnë këtë standart.

Nga ana tjetër, cilësia e ajrit në Shqipëri është renduar në fund të viteve '80 dhe në fillim të viteve '90 për shkak të punës me kapacitet të plote të impjanteve të prodhimit industrial, përgjithësisht, jashtë standardeve teknologjike që janë miqësore me mjedisin.

Në fund të viteve '90 deri tani verëhet ulje e ndotjes së tij nga industria (për mos funksionim të saj në pjesën më të madhe) por paralelisht, verëhet një rritje e ndotjes së ajrit nga shkarkimet e makinave të cilat janë shtuar me një progresion të frikshëm në planin mjedisor.

Te dhënat të cilat vlerësojnë cilësinë mjedisore të ajrit janë ato të qytetit të Kelcyres. Këto të dhëna tregojnë se ndotja e ajrit konsiston në tre elemente: pluhuri, grimcat e blozës të emetuara nga makinat dhe përpunimi dhe prodhimi i materialeve ndërtimore.

Dy parametrat e parë përfshihen në indeksin PM10 (*Particles Matter* <10 μ). PM, sipas të gjitha stacioneve të vrojtimit në zonat urbane (Shqipëri) është 2 deri 4 herë më i lartë se standartet e përcaktuara nga ËHO (*World Health Organisation* - ËHO).

Dy janë burimet e këtyre grimcave në rajonin e Kelcyres: grimcat e pluhurit vijnë nga Rrugët.

Ndonese nuk eshte toksik, Aerosoli qe permban grimca qe vijne nga djegja e karburanteve fosile (*fossil carbons of vehicles*) jane te rrezikeshme per shendetin ; ato jane substanca kancerogjene.

Per sa i perket substancave te tjera volatile dhe kontribuese te cilesise se ajrit si NO₃, NO₂, CO, CO₂, SO₂, Pb, etj. Matjet tregojne se ato nuk jane mbi normat e lejuara (sipas standarteve te EHO).

Nga ana tjeter, çlirimi i tyre ne ajer nuk verehet nga nje burim pykesor (*Source Point Pollution*) duke gene se nuk eshte identifikuar ndonje burim i tille. Ne kete rast, perrjashtuar grimcat e pluhersit dhe blozes ne ajer, substancat e tjera nuk kane ndikim ne mjedisin e segmentit rrugor as edhe ne rajone te tjera te peraferta.

Ne Shqiperi gazoili pa ngarkese (sidomos S, Pb, Cd) nuk disponohet ende dhe mirembajtja e automjeteve shpesh nuk kryhet ne perputhje me rekomandimet e fabrikuesit. Prandaj, shkarkimet nga automjetet permbajne sasira te konsiderueshme te gazrave dhe substancave te padjegura mire.

Konfirmimi i ketyre problemeve eshte nje problematike nacionale qe kerkon aplikimin e standarteve dhe legjislacionit dhe Qeveria Shqiptare ka rritur taksat per karburantin e pashkarkuar per te inkurajuar me shume gazrat pa substance te padjegur, te cilat ndihmojne ne uljen e impaktit.

Tabela permbledhese e ndoteseve atmosferike, efektet dhe burimet e tyre

Ndotesi	Efektet	Burimi	Komente
CO ₂	greenhouse gas	Motorret e makinerive	Mund te hidhet ne ajer
H ₂ S	Arome e vezes se prishur	Prodhimi/perpunimi i naftes ne zonen per rreth	Arome te lehte (permbajtja ne ajer nga 5 deri 10 ppb), por shume e veshtire te eliminohet plotesisht.
SO ₂	Shiu acid	Motorret me nafte Prodhimi/perpunimi i naftes	Kontribut ne shiun acid; mund te reduktohet duke perdorur katalizatore dhe proceset teknologjike te puseve te naftes
Sub. Organike volatile	Efekte toksike dhe krijimin e ozonit	Te ndryshme	Prodhimi/perpunimi i naftes
PM ₁₀	Semundje ne organet e fryme marrjes	Pluheri dhe grimcat suspenduese (aerosol)	Makinat dhe punimet inxhinjerike ne rruge (gjate ndertimit)

Kjo ndotje e ajrit vjen ngaqë rrugët e rrethit të Permetit qarkullojnë shumë autonjete, cilësia e dobët e lëndës djegëse, mirëmbajtja e automjeteve, cilësia e rrugëve, menaxhimi jo efikas i trafikut, etj.

Ndotësit fotokimik, në rrethin e Permetit për vitin 2014 janë:

- Ndotja e O₃ është 57.4 g/m³. Shqipëria 65 g/m³.
- Ndotja e Pb është 0.25 g/m³, 1 g/m³ është norma e Shqipërisë dhe 0.5 g/m³ është norma e BE/
Akoma qarkullon një numër i vogël automjesh që përdorin si lëndë djegëse benzinën.
(Rezultatet e mësipërme janë monitoruar nga Instituti i Shëndetit Publik, gjatë vitit 2014).

3.5.Të dhëna për gjenerimin e Mbetjeve urbane dhe inerte

Në zbatim të Vendimit Nr. 1189 datë 18.11.2009 "Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit", Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ka bërë vëzhgime në drejtim të llogaritjes të sasisë të mbetjeve urbane që prodhon një banor gjatë një viti, Mbështetur në Kushtet konkrete të çdo bashkie si dhe ka ngritur dhe plotësuar "Regjistrin vjetor të prodhimit të mbetjeve urbane dhe inerte sipas Bashkive dhe Qarqeve".

Tabela. Gjenerimi i mbetjeve sipas qarqeve, viti 2013

Nr.	Qarku	Popullsia	Sasia vjetore Ton/banorë	Sasia vjetore Mb.urbane/ton	Sasia vjetore Mb.inerte/ton
1	QARKU BERAT	230764	0.209	48353	18050
2	Qarku DIBËR	177974	0.186	33178	16080
3	Qarku ELBASAN	285878	0.239	68461	28900
4	Qarku FIER	501002	0.325	163214	14566
5	Qarku GJIROKASTËR	103732	0.364	37862	44672
6	Qarku KORÇË	376562	0.206	77846	8162
7	Qarku KUKËS	116061	0.148	17232	6700
8	Qarku LEZHË	210748	0.312	65910	15945
9	Qarku SHKODËR	339072	0.195	66453	12510.5
10	Qarku TIRANË	1030508	0.328	308926	48751
11	Qarku VLORË	368514	0.265	97891	74432
TOTALI		4023415	0.224	1039455	293360.5


Burimi: Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës

Siç vihet re nga tabela, Qarku i Tiranës gjeneron sasinë më të mëdha të mbetjeve urbane ndërsa Qarku i Vlorës gjeneron sasinë më të madhe të mbetjeve inerte duke i krahasuar me qarqet e tjera.

Kjo shpjegohet me numrin e madh të popullsisë si dhe zhvillimin ekonomik (prioritar sektori i ndërtimit) në këto qarqe.


Llogaritja e sasisë së mbetjeve të ngurta urbane është bërë për të gjitha bashkitë dhe komunat. Krahasuar me vitin e kaluar, vihet re një ulje e ndjeshme e shumës totale të mbetjeve.

Figura. Gjenerimi i mbetjeve urbane sipas qarqeve për vitin 2013



Siç vihet re nga paraqitja grafike sasia më e madhe e mbetjeve urbane të gjeneruara për vitin 2013 është në qarkun e Tiranës, e ndjekur nga qarku i Fierit dhe i Vlorës

Figura. Gjenerimi i mbetjeve inerte sipas qarqeve për vitin 2013



Siç vihet re nga paraqitja grafike sasia më e madhe e mbetjeve inerte të gjeneruara për vitin 2013 është në qarkun e Vlorës, e ndjekur nga qarku i Tiranës dhe i Gjirokastrës.

3.6. Zhurmat

Lidhur me zhurmat, ne zonen e studimit nuk ka ndonje informacion ne lidhje me nivelet e ndotjes se ambientit. Zhurma nuk eshte shqetesimi kryesor ne zonen qe rrethon kete zone rurale drejtperdrejt. Aty nuk ka burime emetimi te ndjeshem zhurmash. Nivelet e zhurmes brenda fshatrave jane tipike per çdo zone rurale te nivelit te fshatrave dhe jane te lidhura kryesisht me trafikun e automjeteve qe eshte ne nivel minimal por infrastruktura e dobet ndikon ne rritjen e ketij niveli. Megjithate rekomandohet qe nivelet e zhurmes duhet te monitorohen gjate zhvillimit te aktivitetit.

3.7. Mjedisi social ekonomik

Ekonomia shqiptare, duke perjetuar periudhen e tranzicionit, vitet e fundit ka mundur te siguroje stabilitet nga pikepamja e treguesve makroekonomike. Per vitin 2009, rritja reale vleresohet ne masen 3,5 % te GDP-se, norma mesatare e inflacionit eshte mbajtur ne kufijte 2.4 %, duke deshmuar gjithashtu nje stabilitet ne nivelin e fmimeve ne pergjithesi. Ne drejtim te struktures dhe degeve te zhvillimit te ekonomise, pesha specifike e disa sektoreve tradicionale si p.sh; bujqesia rezulton me renie 21.5% te GDP-se. Ndersa verehet rritje ne disa sektore te tjere si: sherbimet 43,1 %, ndertimi 17,3%, etj.

Te gjitha reformat dhe ndryshimet strukture te ndermarra nga qeveria kane ndikuar ne zhvillimin e ekonomise se vendit duke e orientuar gjithnje e me shume drejt integrimin rajonal dhe global. Ekonomia shqiptare, si nje ekonomi e hapur, eshte gjithnje e me shume e ekspozuar dhe e ndikuar, jo vetem nga faktore te brendshem por edhe nga faktoret e jashtem ekonomik, te cilet e vendosin ekonomine ne pozitat e perballjes me nje konkurrence te forte nga tregu nderkombetar.

Tipari thelbësor i ekonomise shqiptare eshte se ajo ndodhet ne stadin e ekonomive ne zhvillim dhe ristrukturim, gje qe shtron si nje imperativ te dites dhe te perspektives, shfrytezimin e resurseve dhe avantazheve krahasuese, qe ka ne raport me ekonomite e rajonit. Tashme ekonomia e vendit tone, eshte bere pjese perberese e nismave per liberalizimin dhe lehtesimin e tregtise ne nivel rajonal. Pjesemarrja aktive ne keto nisma, shton mundesite e ekonomise sone per tu profilizuar dhe njekohesisht kerkon angazhime ne drejtim te rritjes se konkurruesmerise se produkteve dhe sherbimeve.



Pamje e hapsires perpara godines se aktivitetit

4 INFORMACION PER UJRAT NE ZONEN KU ZHVILLOHET PROJEKTI

4.1. Kushtet hidrologjike

Sipas studimeve hidrologjike ,Rajoni i Kelcyres perfaqesohet nga nje rrjet i rralle hidrologjik.

Ne lumin Vjosa derdhen edhe ujerat e perrenjeve dhe i proskave qe kane shtrirje Jug Perendim-Veri Lindje dhe Veri-Jug qe zbresin nga shpatet malore te Trebeshines.

Perrenjte qe ndertojne rrjetin hidrografik te ketij rajoni kane shtrirje kryesisht Jug Perendim-Veri Lindje per gjate shtrirjes se antiklinalit karbonatik te antiklinalit te Trebeshines.

Në pjesën më të madhe të zonës niveli i ujrave nëntokësore është shumë afër sipërfaqes së tokës, në verë ky nivel është më i thellë nga sipërfaqja e tokës. Në këtë rajon takohen ujërat nëntokësore në depozitat në një thellësi 14 m deri në 18 m.

Gryka e Këlcyrës është një grykë me pamje spektakolare në Qytetin e Këlcyrës.
(13km e gjatë dhe 1000 m e thellë).

Vend pushimi në të cilin gjenden burime ujore malore të cilat derdhen në lumin Vjosë në formë ujrash, të rrethuara nga një masiv pemësh.

Është peizazh karakteristik ku ndërthuren natyrshëm bimësia barishtore, drurët pyjorë me bimësinë higro – hidrofile që gjendet përgjatë burimeve ujore në shtratin e lumit Vjose, habitat ku shprehen mirë të gjitha tipet e bimësisë. Gjatësia e kësaj lugine është 13 km dhe gjerësia 1 – 1.5 km.

Në largësinë rreth 3 km nga qyteti Këlcyrës ndodhen *Rrepet e Grykës*, objekt që funksionon si pikë turistike. Peizazhi i drurëve pyjorë i harmonizuar me burime të bollshme ujore ka vlera atraktive, estetike e ekoturistike. Përgjatë luginës Gryka e Këlcyrës gjendet burimi ujqor *Ujëti e Zi*, që ruan kaltërsinë edhe kur përzihet me ujërat e lumit Vjosë.

Ky peizazh ka vlera mjedisore të pazvendësueshme, tepër çlodhës dhe rekreativ për vizitorët. Frekuentohet nga vizitorë vendas dhe të huaj.

Prane vendodhjes se aktivitetit kalon lumi i Vjoses.

Vjosë është një lum, i cili buron në veriperëndim të Greqia në Epir dhe derdhet në Shqipëri në Detin Adriatik. Lumi Vjosa rrjedh nga **malet** e Pindit në lindje të Janinës, kurse burimi gjendet në malin *Mavrovouni*. Rrjedha e tij vazhdon në drejtim të veriperëndimit për në Shqipëri. Lumi ka një gjatësi prej rreth 272km, prej të cilave 80 km në territorin e Greqisë, kurse rreth 192 km brenda territorit të Shqipërisë. Vjosa lag zona me një sipërfaqe prej 6.706 km², 2.154 km² prej të cilave gjenden brenda kufijve të Greqisë, dhe 4552 km² brenda kufijve të Shqipërisë.

Prurja mesatare e ujrave në grykëderdhje është rreth 204 m³/s. Në muajin prill prurja është rreth dhjetë herë më e madhe se në gusht.

Sipas studimeve hidrogeologjike, Rajoni i Kelcyres perfaqesohet nga nje rrjet i rralle hidrografik. Ne mesin e Grykes se Kelcyres eshte ndertuar objekti i nderteses i qendres se impjantit te perpunimit te ujit dhe ne kete teritor eshte edhe pozicioni i pusit te projektuar Kelcyra-1.

Ky pus ka per qellim sigurimin e reserves ujore nentoksore dhe furnizon me uje qendren perpunuese te ujit TREBESHINA . Ne anen jugore te ketij objekti kalon lumi Vjosa qe iken drejt perendimit.

Ne jug te Objektit i Subjektit "TREBESHINA L.t.d" Sh.P.K. ndodhen burimet e fuqishme te grykes se Kelcyres qe kane debite rreth 5000l/ore dhe derdhen ne lumin Vjosa.

Ne lumin Vjosa derdhen edhe ujerat e perrenjeve dhe i proskave qe kane shtrirje Jug Perendim-VeriLindje dhe Veri-Jug qe zbresin nga shpatet malore te Trebeshines.

Perrenjte qe ndertojne rrjetin hidrografik te ketij rajoni kane shtrirje kryesisht Jug Perendim-Veri Lindje per gjate shtrirjes se antiklinalit karbonatik te antiklinalit te Trebeshines.

Në pjesën më të madhe të zonës niveli i ujrave nëntokësore është shumë afër sipërfaqes së tokës, në verë ky nivel është më i thellë nga sipërfaqja e tokës. Në këtë rajon takohen ujërat nëntokësore në depozitat zhavorr dhe në një thellësi 14 m deri në 18 m.

Pjesa e sipërme e lumit në Greqi kalon shpesh herë midis zonave malore me pyje. Një pjesë e tyre janë zona të mbrojtura natyrore dhe që i përkasin parkut kombëtar Vikos-Aoos, i cili shtrihet për rreth maleve Timfi (2.497 m. mbi nivelin e detit). Në këtë park, i cili është dhe parku i dytë më i madh i Greqisë jetojnë edhe sot arinj të kaftë.

Përroi Vojdomati një degë e Vjosës krijon grykën e Vikos, një grykë kjo tepër e mahnitshme. Duke pasur parasysh koeficientin (0,82) të thellësisë (900 m.) me atë të gjerësisë (1100 m.), gryka e Vikos-Aoos vlen si gryka më e thellë në botë. (Ka zona në botë që janë më të thella por edhe më të gjera dhe anasjelltas). Kjo zonë quhet Zagoria dhe është e njohur jo vetëm si zonë për alpinizëm, por edhe për fshatrat karakteristike me shtëpi prej guri.

Jo larg nga Konica brenda për brenda parkut kombëtar kalon edhe Vjosa në një grykë të ngushtë. Në Konicë ndodhet dhe një urë historike me harqe prej guri, e cila është ndërtuar mbi Vjosë. Prej këtu e tutje lumi shfrytëzohet edhe për qëllime ekonomiko-bujqësore.

Gryka e Këlcyrës, e thënë ndryshe edhe si parajsa e njëmijë e një burimeve. Është një nga vendet më piktoreske shqiptare e pasur me ujëvara, burime, parqe e sidomos gjallëri natyrore.

Godina e Kompanisë "TREBESHINA L.t.d." Sh.P.K. është e vendosur pranë Vargmalit Trebeshinë – Dhëmbël – Nemërçkë

Ky varg malor përbën fare mirë një qendër për turizëm alpinist. Ekskursionet dhe piknikët janë të panumërta në stinën e verës. Megjithatë, gjatë dimrit, kur bora mbulon majat e malit, një udhëtim i vogël, shëtitje apo çfarëdo qoftë, është vërtet një përvojë që nuk duhet lënë pa u jetuar.

Për të kuptuar më mirë bukuritë e njërës prej pikave natyrore më tërheqëse të Shqipërisë, është mirë që udhëtimin ta nisni nga juglindja e Shqipërisë, në itinerarin vazhdues Korçë-Leskovik-Përmet-Tepelenë, ashtu siç vepruam edhe ne.

Arsyeja e thjeshtë është sepse përgjatë të gjithë udhëtimit në drejtimin jug-veri, ju shoqëron rrjedha e smeraldtë e Vjosës dhe vargmalet më të bukura shqiptare, trioja Trebeshinë-Dhëmbël-Nemërçkë.

Ku do të ndalemi jo thjesht për t'u freskuar, kemi zgjedhur Grykën e Këlcyrës, ose ndryshe, parajsën e njëmijë e një burimeve, që zbresin nga malet e Trebeshinës e derdhen në Vjosë.

Gryka e Këlcyrës ndodhet në Rrethin e Përmetit dhe në të ndodhet një nga burimet ujore më të bukura të Shqipërisë, Burimi i Ujit të Zi, i cili ndonëse jo shumë i përmendur siç mund të thoshim për pika të tjera ujore të natyrës shqiptare, është një vend i mrekullueshëm që vlen të vizitohet.

Këlcyra është një qytet që shtrihet përgjatë maleve Trebeshinë dhe Nemërçkë dhe laget nga lumi Vjosës dhe Dishnicës.

Udha për në Këlcyrë, mund të merret edhe pasi shkëputeni nga rruga Tepelenë-Gjirokastër dhe lë në të djathtë rrënojat e qytetit të lashtë të Antigonesë. Madhështore dhe hijerëndë Gryka e Këlcyrës çan mes honesh të thepisura dhe mbërrin në pikën më të lartë të pllajës që shtrihet mes Malit të Trebeshinës e

Nemërçkës në qytetin e Këlcyrës, që është i vendosur në të djathtë të Vjosës, aty ku lumi i Dishnicës së bashku me degët e veta nis bashkërrjedhjen me Vjosën.

Në çdo stinë panorama që iu dhuron kjo zonë është e mrekullueshme. Ne preferuam ta vizitojmë atë në vjeshtë, kur natyra luan me një spektakël të vërtetë ngjyrash, duke filluar që nga maja e bardhë e Trebeshinës që kishte mirëpritur borën e parë, për të vazhduar me të murrmen e shkurnajës, me të gjelbrën e përhershme të bredhave e pishave, me të verdhën e rrepave shekullore, e për të mbaruar me të bruztën e ujit të Vjosës, ku derdhen burimet e panumërta.

Ky vend i mrekullueshëm ujqor quhet Burimi i Ujit të Zi, dhe është peizazh karakteristik ku ndërthuren natyrshëm bimësia barishtore, drurët pyjorë me bimësinë higro-hidrofile që gjendet përgjatë burimeve ujore në shtratin e lumit Vjosë, habitat ku shprehen mirë të gjitha tipet e bimësisë.

Ujëvarat e vogla që zbresin nga mali e kanë marrë emrin Uji i Zi sepse pelgjet që krijojnë para se të derdhen në Vjosë, marrin një ngjyrë të errët, të thellë. Uji përveçse është i pastër Kristal, ka edhe vlera të jashtëzakonshme kuruese dhe të dobishme për organizmin. Uji është i pijshëm dhe përdoret nga të gjithë lokalet që kanë mbushur zonën e rrepeve dhe që ofrojnë shërbime të shumta për pushuesit.



Gryka e Kelecyres




FIGURA Nr. 1. HARTA GJEOLGJIKE RAJONI KELCYRE

Lumi Vjosa, rrjedha e të cilit përshkon jugun e Shqipërisë, është dhe kufiri ndarës natyror midis rrethit të Fierit (në veri) dhe rrethit të Vlorës. Ai është një lum i lundrueshëm, pasi ai rrjedh kryesisht në zona fushore.

Si efekt i procesit të reshjeve atmosferike ndodhin infiltrimet nga sipërfaqe e tokës drejt thellesis në shtresat me veti të mira kolektorale që përçojnë ujerat në objektet nentoksore.

Duke u nisur nga fakti se në kuotat relativisht të larta të rajonit, për kushtet gjeomorfologjike që ai disponon, si zona ushqimi shërbejnë sektoret juglindor dhe përdimor ku ekspozohen në sipërfaqe shkëmbinjet e kompleksit karbonatik, flishore dhe ato të kuaternarit, duke forcuar objekte ujore nentoksore që paraqiten me tiparet e tyre hidrogeologjike në rajonin e Kelcyres dhe veçanërisht zona e Grykes së Kelcyres ku ndodhen burimet ujore kryesore që është zona e studimit dhe projektimit të pusit Kelcyra 1 për ujë industrial.

Si të tilla këto depozitime karbonatik e janë objektet kryesorë ujorë me interes të lartë si objekt ujorë nentoksore në Kompleksin karbonatik të Kretak - Paleogenit në dallim nga komplekset e tjera terigjene flishore ose mollasike të Kuaternarit që paraqesin interes të vogël për shfrytëzim të ujit në këto zone të studimit të rajonit. të cilat po i paraqesim në këto material.

Rajoni paraqitet me një regjim hidrodinamik të zhvilluar dhe karakterizohet nga burime natyrore që dalin e derdhen në sipërfaqe. Studimi në kompleksin i ujerave sipërfaqësore dhe nentoksore është me efektivitet duke i studjuar ato në kompleksitetin e faktoreve gjeologjike dhe hidrogeologjike dhe duke përcaktuar origjinin dhe lëvizjen hidrodinamike të tyre.

Në rajon janë evidentuar dy komplekse ujembajtës:

Kompleksi ujembajtës i depozitimeve karbonatike (Cr2—Pgz) .

Kompleksi ujembajtës i depozitimeve Mollasike-kuaternare (Q).

Nga këto komplekse ujembajtëse më i rëndësishëm në rajon dhe në zonën e studimit e të projektimit është: ai karbonatik pasi komplekset e tjera shtrihen jashtë kontureve të zonës së studimit dhe kanë një rëndësi më të vogël për ujembajtje se ai karbonatik me të cilat lidhen një numër i konsiderueshëm burimesh ujore të cilat kanë debilitet relativisht të mbedha e të qëndrueshme. Në mbizoterojnë burimet ujore të tipit tektoniko - karstik.

Ujembajtja e këtij kompleksi është e vertetuar me daljen e burimeve ujore sipërfaqësore gjatë linjës tektonike me shtrirje JL-VP.

Për ujerat e këtij kompleksi në rajon disponohet një sasi e konsiderueshme analizash dhe vrojtimesh nga ana strukturore, për ujin ujor lidhet me strukturën antilinale të Trebeshinës që ndërtohet me depozitimet e kompleksit karbonatik të Kretak - Paleogenit dhe mbi të në pjesën qendrore mbivendosen depozitimet mollasike brekciuze në formë taracash lumore. Depozitimet e kompleksit ujor të Kuaternarit në luginën e Lumit Vjosa kanë një trashësi relativisht të vogël 2 - 8.00 m, që përfshihen në pellgun ujor të basenit të Vjoses.

Keto depozitime Kuaternare shtrihen mbi antiklinalit karbonatik te Trebeshines.

Thellsia e depozitimeve te Kuaternarit arrin 2.00-8.00 m.

Kompleksi i depozitimeve karbonatike nderton antiklinalin e "Trebeshines i cili ndodhet ne vargun antiklinal te Nemerçke Trebeshine qe inklidohet sipas rajonizimit tektonike te Albanideve, ne Brezin antiklinal te Beratit. Uje mbajtja e ketij pellgu perveç kompleksit karbonatik eshte e vertetuar edhe ne depozitimet e kompleksit ujqor fushor dhe atij te kuaternarit qe paraqiten me burime me debite ujqore te vogla.

Duke u bazuar mbi ndertimin gjellogjik te rajonit te Kelcyres, ne pergjithesi te krijohet bindja dhe perfytyrimi se kushtet hidrogjeologjike te njesive te caktuara tektonike e dhe strukturore jane te kushtezuara dhe jane ne vartesi te disa parametrave hidrogjeologjike dhe tektonike e litofacial si me poshte :

Forza e gjendjes ujqore nentoksore e natyrore ne basenet ujqore, komplekset qe ndertojne ato dhe perfaqesimi litologo- facial i tyre.

- Veçimi i objekteve ose i horizonteve ujqore.
- Roli i tektonikes ose / sistemeve te çarieve apo i fenomeneve te karstit.
- Vetite kolektorale; poroziteti, pershkushmeria dhe aftesit filtruese ne objektet ujqore.

Bazuar ne ndertimin gjellogjik e tektonik te rajonit veçojme basenin ujqore te Brezit te Cikes

Ne kete basen marin pjese depozitimet e kompleksit karbonatik, flihor e flihsoidal si dhe depozitimet e reja te Tortonian-Mesenianit - kuaternarit. Keto te fundit formojn Pellgun ujqorbajtes te Vjoses ne perendim te rajonit ne studim, ne rrjedhjen e poshteme te lumit Vjosa me depozitime te kuaternarit me trashsi te vogel deri 8-10 m.

Nga analiza e vetive kolektorale porozitetit dhe pershkushmerise se shkembinjave qe ndertojne basenet ujqore veçojme 2 tipe kryesore shkembinjesh kolektoral :

Kompleksi ujqor i depozitimeve karbonatike (Crz- Pgz), ka perhapje mjaft te madhe, rreth 75 % te siperfaqes se rajonit ne studim. Pjesa ne e madhe shtrihet ne jug lindje dhe perndim te rajonit ne studim. Ne kompleksin e depozitimeve karbonatike nga studimet e kryera veçohet objekti ujqor karbonatik Objekti Ujqor Karbonatik (Cm-Pg 2)

Ne kete objekt ujqorbajtes, perfshihen ujqorat gelqerore te kretakut te siperme, Paleocenit- Eocenit (Cm-Pg). Depozitimet e ketij objekti ndertojne pjesen e siperme te kompleksit karbonatik dhe ekspozohen ne siperfaqe ne te gjitha strukturat antiklinale te rajonit.

Keshtu ky objekt nderton krahun lindor dhe pjesen kulmore te antiklinalit te Trebeshines me renie perendimore.

Depozitimet e ketij objekti fillojne me gelqeroret fosfatike dhe vazhdojne me gelqeroret coprizor, mikritike, pelitomorf, mergelor si dhe pakon kalimtare. Prania e shisteve te Kretakut te poshtem qe sherbejne si izoluese dhe veçon kete objekt nga objekti i me poshtem.

Keto formacione pershkohen nga dy sisteme çarjesh, sistemi meridional dhe normal shtresezimit, me hapsire boshe 2 -22 mm si dhe nga mikroprishje e prishje tektonike me amplitude te vogel 10-20 m spostim me renie normale 90grade.

Çarjet ne sipërfaqe jane te eroduar, te shpelara dhe te karstifikuara. Veprimtarija eroduese e karstit, ne sipërfaqe eshte shume e avancuar, duke krijuar forma te ndryshme relievi: gishtëzime, vrime, brinje dhe gropezime te gjera te veprimtarise karstike te shplara dhe te gerryera.

Sistemet e Carjeve (me teper gjate shtresazimit dhe renies se formacioneve) zgjerohen dhe futen ne thellesi (nepermjet dy sistemeve kryesore te carjeve te orgjines tektonike me dreejtim shtrirje meridionale dhe vertikale me renien e shtresave karbonatike) ne formen e koridoreve, kavernave karstike, me gfaqje tipike te tyre ne zonen e ushqimit te burimeve te fuqishem karstik, (tipi zbrates) qe lidhen me keto koridore, apo kolektor te medhenj ujembajtes, behen per llogari te rreshjeve atmosferike, ne rruge te gjata dhe te thella qarkullimi, nepermjet fushave dhe rrafshnaltave karstike me sipërfaqe ujembledhese relativisht te medha.

Keto ujra me ane te rrjetit te dendur te çarjeve, percillen per ne thellesi duke u grumbulluar keshtu ne kolektoret dhe rezervuarin ujembajtes nentokesore.

4.2. Kompleksi ujembajtes i Kijatarnarit Q

Ujrat e ketij kompleksi takohen ne depozitimet aluviale, deluviale, brekcioze, koluvjale te shpateve dhe proluviale, te cilat marrin pjese ne formimin e Lugines se lumit Vjosa, shtratit te lumit, Konuseve te derdhjes, taracat lumore si dhe ne ndertirmin e shpateve te maleve dhe kodrave ku jane te sedimentuara Peto depozitime. Ky kompleks uJOR, ne studimet e kryera, inkludohet ne shkembinjat jo kompakt, te shkrifet.

Kompleksi i depozitirreve flishore shtrihen ne lindje dhe jug perndim te rajonit ne studimit. Ujmbajtija e ketij kompleksi uJOR ne pergjthesi eshte e dobet.

4.3. Perberja kimike e ujrave

Ne baze te perberjes hidrokimike uJRat veçohen ne tre grupe:

- UJRat e embela ne mineralizim deri 0,25-0.5 gr/liter ketu perfshihen burimet dhe te stacionit te pompimit te ujesjellesit te Kelcyres.
- Ne perendim te fshatit Kelcyre te Qarkut Gjirokastrer, tipi kimik i ujrave eshte hidrokarbonatik i kalciumi dhe jane ujra tipike U infiltracionit.

Plani reflektues per keto ujra nuk eshte vetem ai i prishjeve tektonike ne krahet perendimore dhe lindor te strukturave antiklinale por edhe i nivele kompakte brenda prerjes karbonatike.

Ndikime te tjrave te thellesise nuk vihen re ne sipërfaqe e ne thellesii.

Theksojme se nga studimet hidrokimike te kryera me pare per burimin e Kelcyres jepen me mineralizim te pergjitheshem te ulet 0,280 — 0320 gr/l.

Veti fizike jane shume te mira, pa shije, pa ere, pa ngjyre me fortesi 17.8 grade Gjermane Ph=7.8, me temperaturen e ambientit ne dalje te ujit.

Ne baze te marredhenieve te ketyre tregueseve burimet ujore mund te ndahen:

- Burime ujore me influence te theksuar te ujrave te infiltracionit, e cila kondicionohet nga:
- Prania e zonave me qarkullim mesatar.
- Influenca e prishjeve tektonike.

4.4. Origjina e Ujerve siperfaqesore e nentokesore

Ne pergjithesi morfologjia e karbonateve karakterizohet nga prania e dukurive te tilla si hinta, çarje e gropa karstike, lugina te varura ose puse vertikale e shpella me permasa te ndryshme. Ne karbonatet eshte i zhvilluar dobet rrjeti hidrografik siperfaqesor kurse ai nentokesor eshte mjaft i zhvilluar. Ne vartesi te shkalles e karakterit te zhvillimit te pershkushnerise, ujerat karakterizohen nga levizja ne kanale ose levizje difuzive.

Fenomeni i karstit eshte mjaft i zhvilluar. Ne prerjen vertikale ky fenomen zhvillohet deri ne nivelet e fosfatikut, dhe ne planet tektonike vertikale te prerjes karbonatike (Syri i kalter). Shpella e Sofratikes eshte me origjine karstike. Shpellat karstike kane gene burime te fuqishme uji, por ndryshimi i planit tektonik te strukturave i ekspozoi mbi nivelin statik te ujrave nentokesor ne prerjen karbonatike.

Infiltrimi efikas ne zonat karstike arrin vlera 45-55 % te rreshjeve atmosferike vjetore.

Kjo vlere ne malin e Trebeshines arrin ne 1300-1500 mm/vit.

Fenomeni i karstit eshte i perhapur dhe ne strukturat karbonatike te Trebeshine-Nemerçke. Per prerjen deri ne shistet argjilore te kretakut te poshtem, objekti i pare karbonatik, levizja eshte drejt perendimit, kurse per objektin e dyte karbonatik, eshte kryesisht ne lindje, pa perjashtuar dhe levizjen drejt perendimit.

Ujrat nentokesore perfundojne levizjen e tyre kur ato shfaqen ne siperfaqe ne formen e burimeve.

Burimet mund te klasifikohen ne keto kategori duke u bazuar ne situaten gjeologjike:

- Burime te lidhura me ekranizimet e prerjes flishore ne kalimin gradual me ate karbonatike.
- Burime te lidhura me ekranizimet ne kontaktin tektonik te prerjes karbonatike me ate flishore, lerigjene.

4.5. Cilesia e ujrave nentokesore :

- Ujë që plotëson standardet sipas:

- Standardeve te Komunitetit Evropian Direktiva 98/83 EU
(3 Nëntor 1998 – Cilësia e Ujit i destinuar për konsum Njerëzor)
- Codex Stan 108- 1981, i rinovuar 227-2001
(Standard i përgjithshëm për imbotilimin dhe paketimin e ujit te pijshëm)

- Legjislacioni Shqiptar Nr. 9863 / 2008 (SSH Uji i Pijshëm)
- Ujë me persosmerine e ekuilibrit te mineraleve .
- Ujë mikrobiologjikisht i pastër dhe Temperature te Burimit = 11.4°C.
- Uji përshkon filtrat mekanik 200; 50; 20; 5 & 3 mikron dhe ata 0.01µ me P= 2 bar.

Fizike – Kimike

Ngjyra – 0 (PCU)

pH - 7.6

Aroma – 0

Kond. – 518 µS/cm

Shija - 0

Turbullira-0 (NT)

Fortesia – 235 ppm

Kripera te tretura- 286mg/l

ANIONE: mg/L Limit

Cl⁻.....40 250

NO₃⁻.....1.4 50

SO₄²⁻.....92 250

F⁻0.2 1.5

HCO₃⁻.183 250

KATIONE : mg/L Limit: (mg/l)

Mn²⁺ ...0 0.5

Na⁺...25 200

K⁺ ...<1 12

Ca²⁺ ...84 100 +∞

Mg²⁺ ...7.4 50

Metale te renda : (mg/l)

Limit: (mg/l)

Si 6 100

As <0.001 0.01

B <0.001 0.01

Cd <0.0001 0.003

Cr <0.001 0.05

Cu	<0.005	1
Ni	<0.002	0.05
Zn	<0.01	0.05
Co	<0.01	0.05
Fe	<0.005	0.05
Mn	<0.001	0.5
Substanca	organike : µg/l	Limit : µg/l
ClCH ₂ CH ₂ Cl	<10	30
C ₂ HCl ₃	<.0.1	1
C ₂ Cl ₄	<0.1	1
C ₆ H ₆	<0.01	0.1
C ₂₀ H ₁₂	<0.0025	0.01
Mikrobiologjike		
Parametra	Vlera	Limit ; cfu/ ml
Coloni 22 °C	0 cfu/1ml	<100
Coloni 37 °C	0 cfu/1ml	<20
Clostd. Perfringens	0 cfu/250ml	0
Esheria.Coli	0 cfu/250ml	0
Fekal Streptokok	0 cfu/250ml	0
Total Coliform	0 cfu/250ml	0
Psd.aerug.	0 cfu/250ml	0
Enterococci	0 cfu/250ml	0
Sulphite- reducing	0 cfu/50ml	0

4.6. Regjimi hidrodinamik i Rajonit

Rajoni ne studim nga pikpamja e regjimit hidrodinamik eshte agresiv.

Vegorite hidrokimike te rajonit percaktohen nga faktoret e meposhtem:

- Ekspozim i theksuar i prerjes karbonatike ne siperfaqe qe perfaqeson nje nga zonat kryesore te ushqimit te basenit ujembajtes te Shqiperise jugore.
- Variacionet e vetive kolektorale te depozitimeve karbonatik e si ne shtrirje dhe ne prerje vertikale.

Mungesa e komunikimit hidrodinamik te linjave antiklinale te ekspozuara ne siperfaqe.

Objektivat e marketingut te kompanise do te bazohen ne eksperiencat e meparshme, c'ka perkthehet ne njohje te thelle te kerkesave te tregut vendas dhe atij rajonal per ujin e imbotiluar dhe ne nje bashkepunim te fuqishem me kompanite nderkombetare. Objektiv i kryesor eshte qe te krijohet nje partneritet me grupet nderkombetare, te cilat sigurojne tregje te vecanta ku produkti shqiptar jo vetem gjen nje perdorim te gjere, por hap rrugen edhe per produkte te tjera shqiptare me cilesi te larte dhe me vlera te medha ekonomike.

9.9. Transporti, Paisjet dhe mjetet transportuese

Transporti i ujit te paketuar per ne tregun vendas dhe ate rajonal do te behet me kamjone. Vetem nje pjese rreth 25 km eshte rruge e ngushte dhe pastaj automjetet hyjne ne rruget e reja e te gjera qe kane perfunduar ose jane ne planet afat shkurtera te Qeverise.

Stabilimenti verifikon që mjetet e transportit janë të përshtatshme për transportin e produktit ushqimor dhe nuk përbëjnë rrezikshmëri për kontaminimin e produktit. Ato janë të konstruara për kontakt me ushqimin dhe nuk përdoren për materiale që nuk kanë të bëjnë me të.

Stabilimenti ka një program për pastrimin dhe sanitarizimin e mjeteve të transportit. Mjetet e transportit ngarkohen dhe të shkarkohen në mënyrë të tillë që të parandalojnë dëmtimin dhe kontaminimin e ushqimit. Produkti përfundimtar transportohet nën kushte të përshtatshme për të parandaluar kontaminimet mikrobiologjike, fizike dhe kimike.

Për transportimin e produktit të gatshëm dhe dërgimin e tij në magazinim dhe më pas kalimin në hapësirën e distribucionit për ngarkimin e mjeteve të shpërndarjes, Stabilimenti disponon dy piruna transportues të cilët janë me bateri.

9.10. Çelesi i Suksesit

- Teritori ku është vendosur objekti është mjaft i përshtatshëm për funksionimin e këtij aktivitetit, duke pasur parasysh:
- Vendosja në krah të Rrugës Nacionale Tepelene - Kelcyre, lehtëson transportin e brendshëm të ujit të imbotiluar.
- Objekti ka një sistem shumë të sigurtë të furnizimit me energji elektrike.
- Çelesi i suksesit në këtë projekt ngelet sigurimi i një infrastrukture të zhvilluar dhe të pastert në mënyrë që të garantohet cilësia. Me këtë nënkuptohet një investim i studjuar mirë ku garantohet që teknologjia e përdorur në fabrike, në asnjë moment nuk kompromenton cilësinë e produktit.
- Gjithashtu, çeli i suksesit mbetet edhe infrastruktura, në një mënyrë sa më eficiente dhe në harmoni me natyrën, në mënyrë që vizualisht mos të krijojë probleme për komunitetin dhe për zhvillimin e turizmit në këtë zonë me vlera të mëdha natyrore.
- Çeli i suksesi do të jetë edhe agresiviteti i kompanisë për të njohur tregun vendas dhe atë rajonal dhe për tju përgjigjur në kohë, me cilësi dhe me çmim konkurrues kerkesave të tij.
- Dhe së fundmi, çeli i suksesit mbetet edhe bashkëpunimi me grupet ndërkombetare që do të sigurojnë tregun e këtij produkti dhe promovimin e ujit shqiptar në tregjet e huaja.

9.11. Hapësira e përgjithshme e Stabilimentit

Ndërtesat dhe hapësira rreth tyre është projektuar dhe ndërtuar në mënyrë të tillë që të krijojë kushte parandaluese për kontaminimin e produktit që prodhohet.

9.12. Hapsira e jashtme

Sabilimentit është pozicionuar në një hapësirë e cila është e lirë dhe e mbrojtur nga kontaminimet mjedisore ose industriale (si. ndikime për krijim aromash të pa këndëshme, tymra, pluhura etj) Infrastruktura rrugore rreth Stabilimentit është e asfaltuar dhe e qëndrueshme duke realizuar mbrojtjen nga pluhurat si dhe aftësinë e duhur për largimin e ujit në rast shirash. Rrugët krijojnë mundësi shumë të mira për mjetet e transportit të cilat furnizojnë me materiale dhe transportojnë produktin e gatshëm në destinacion.

Godinat janë të mbrojtura nga zhurmat dhe të mirëmbajtura mirë dhe nuk paraqesin asnjë rrezik për kontaminimin e produktit nga ndonjë prezencë kimike, biologjike ose fizike.

Ekzistojnë hapësira të gjelbëra brenda hapësirës së Stabilimentit.



Pamje e murit rrethues

9.13. Zona jashtë Ndërtesave dhe Ndërtesat

Çdo ndërtesë është e projektuar që :

- të sigurojë kushte të përshtatshme mjedisore;
- të lejojë pastrim dhe sanitarizim të mjaftueshëm;
- të minimizojë kontaminimin nga faktorë të jashtëm;
- të parandalojë hyrjen e insekteve dhe
- të sigurojë hapësirë të mjaftueshme për të kryer proceset e nevojshme operationale.

9.14. Hapësira e brendshme e ndërtesave.

Hapësira e brendshme e ndërtesave është e pastër dhe e projektuar për të krijuar lehtësi pune dhe komunikimi për stafin.

9.15. Projektimi, Konstruktimi dhe Mirëmbajtja.

Materialet e dyshemeve (të mbuluara me çimento industriale të fërkuar), mureve dhe tavanet janë të përshtatshme dhe të pranueshme në linjat e prodhimit për produkt ushqimor.

Ekzistojnë tualetet dhe vendi për larjen e duarve i cili është projektuar për të siguruar hapësirë të përshtatshme për kalimin e lirë të personelit.

Dhomat e zhveshjes (garderobat) për personelin . Punëtorët që operojnë në linjat e prodhimit kanë mundësi që nga dhomat e zhveshjes të kalojnë në vendin e larjes së duarve përpara se të hynë në ambientet e prodhimit. Kalimi në ambientet e prodhimit realizohet nëpërmjet deryeve automatike me grila plastike, që të mos preken nga duart e punonjësve por dhe të parandalojnë hyrjen e insekteve ose brejtësve në ambientet e prodhimit.

Materialet e dyshemeve dhe mureve janë të lëmuara, lehtësisht të pastrueshme dhe të përshtatshme për prodhimin.

Këndet e dyshemeve janë të mbrojtura dhe të konstruara për të parandaluar kontaminimet dhe për tu larë lehtësisht. Dyshemeja ka pjerrësi të përshtatshme për të bërë të mundur rrjedhjen e ujit larës.

- Dritaret janë të mbyllura mirë .

Operacione dhe procedura higjene janë krijuar në mënyrë që të mbështesin sa më mirë kalimin e lëndëve të para në ambientet e prodhimit të produktit final.

-Ndarja operationale ose fizike e ambienteve për të parandaluar kontaminimin e produktit nga kryqëzimi i lëvizjeve të personelit, vizitorëve dhe paisjeve.

-Projektimi i një harte ku të paraqiten me ngjyra dhe shenja zonat më pak të kontaminura dhe zonat me mundësi të madhe kontaminimi në mënyrë që të orjentoher lëvizja e njerëzve nga zonat më pak të kontaminuara tek ato me mundësi kontaminimi dhe jo anasjelltas.

-Lëvizjet e personelit të zyrave janë të kontrolluara dhe realizohen direkt në sektorët e prodhimit, transportimit dhe magazinimit të produktit.

9.16. Ndriçimi

Ndriçimi është i përshtatshëm për të lejuar mundësinë e inspektimit të produktit dhe mos të krijojë ndryshime në ngjyrën e produktit të gatshëm. Në hapësirën ku realizohet produkti dhe ambalazhimi ndriçuesit janë të fiksuar mirë dhe të siguruar në mënyrë që të parandalohet çdo mundësi kontaminimi në rast thyerje ose të jenë lehtësisht të çmontueshëm në rast të ndërrimit të llambave. Në Stabiliment sistemi i ndriçimit është i përshtatshëm për të krijuar dritën e nevojshme në ambient.

9.17. Ventilimi

Ventilimi është i nevojshëm për të ruajtur temperaturën dhe lagështinë relative të duhur në ambientin e prodhimit dhe për të parandaluar kondensimet, pluhurat etj. Zakonisht temperatura e përshtatshme në ambientet e prodhimit është 20-25⁰C dhe lagështia relative e përshtatshme në ambientet e prodhimit është 50-65 % e cila monitorohet çdo ditë me aparaturat perkatese (termohigrometrat e vendosur ne gjithë ambientet e Stabilimentit).

9.18. Vëndet e hedhjes së plehrave dhe shkarkimeve.

Drenazhet dhe koshat e plehrave janë të përshtatur në mënyrë të tillë që të mos ketë kryqëzime midis mbetjeve njerëzore dhe atyre industriale.

Jane të siguruar në vende të caktuara dhe lehtësisht të zhvendosëshme nga ambientet e Stabilimentit. Jane përcaktuar vendet ku duhet të vendosen kontenierët për mbetjet e ndryshme të ndara sipas llojit në mënyrë që të mos jenë burim kontaminimi dhe bëhet largimi i tyre nga Stabilimenti nga kompani te autorizuar dhe të kontraktuara ne bashkine e Kelcyres.

9.19. Hapësira e materialeve të pa përdorshme.

Është përcaktuar një hapësirë për stokimin e materialeve të pa përdorëshme të tilla si mbetje kartonash, shishe PET të dëmtuara dhe skarcitete, paleta druri të dëmtuara etj, të cilat Stabilimenti i shet për riciklim ose i dërgon për riparime. Këto materiale janë të ndara nga materialet që përdoren për prodhimin dhe ambalazhimin e ujit të pijshëm, dhe zhvendosen nga Stabilimenti sipas pocedurave të kërkuara.

9.20. Shërbimet e Sanitare, Shërbimet ndaj personelit punëtor

Në Stabiliment ekzistojnë tualetet të cilat janë të projektuara në përshtatje me kërkesat e prodhimit të produktit ushqimor. Kalimet nga tualetet në ambientin e prodhimit janë të lidhura me dyer vetë-mbyllëse.

Dhomat e zhveshjes dhe mensa për ngrënie e ushqimit nga personeli. Është e rëndësishme që ato janë të ndara nga ambientet e prodhimit dhe sigurohet në çdo kohë higjiena maksimale në to. Numri i lavamanëve për larjen e duarve është i përshtatshëm me numrin e personelit. Në vendin e larjes së duarve është afishuar "Rregullorja e Larjes së duarve" e cila e instrukturon personelin me mënyrën e realizimit të këtij procesi. Lavamanët janë të pajisur me ujë të pastër të ngrohtë dhe të ftohtë, sapun, letër për tharjen e duarve dhe kontenerë të përshtatshëm për hedhjen e mbetjeve.

9.21. Paisjet e pastrimit dhe shërbimit sanitar

Paisjet që përdoren për pastrim dhe sanitarizim janë prej materiali që pastrohen lehtë dhe të konstruara me materiale rezistente ndaj korrozionit. Uji që përdoret për pastrim dhe sanitarizim është i pastër dhe në temperaturën e duhur për pastrim. Paisjet dhe lëndët që përdoren për pastrim janë të ndara nga magazinat ku mbahen materialet për paketimin dhe prodhimin e produktit. Këto lëndë magazinohen në një hapësirë të veçantë ku vendosen nëpër raftet dhe të ndahen sipas rrezikshmërisë dhe agresivitetit. Nuk duhet të vihen pranë njëri tjetrit lëndë që kanë aktivitet me njëri tjetrin (p.sh lëndë me natyrë bazike me ato me natyrë acide). Në raftet, ato etiketohen për një identifikim më të mirë të tyre dhe në rast se ka lëndë që reagojnë ndaj dritës stokimi bëhet në vende të errëta. Materialet nuk vendosen direkt në tokë pasi mund të veprojnë kimikisht me dyshemënë.

9.22. Infrastruktura shtese

Për funksionimin e kësaj veprimtarie, nuk janë hapur rrugë të reja. Sistemi rrugor i zonës është ekzistues dhe në gjendje të mirë. Rruga automobilistike ekzistuese kalon pranë objektit, Rruga Nacionale "Tepelene - Kelcyre".

Ky studim përcakton një mënyrë zhvillimi të kësaj zone duke përcaktuar disa kritere parimore mbi zonën, zhvillimin e projektit etj.

9.23. Vendodhja e Projektit

Subjekti ka për qëllim zhvillimin e projektit "Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera për rimbushjen artificiale të ujrave nentoksore".

Sheshi ka nje siperfaqe totale te truallit prej **39325m²**, e rregjistruar ne Z.V.R.P. ne zonen **kadastrale Nr. 2131**, me **Nr.Pasurie 364/4,13,14,15,16,17,18,19,20,21** volume 8, faqe 238 me Indeks te hartes K-34-137 (22-C) ne Kelcyre, Permet me date 16.08.2011.

dhe kufizohet :

Nga Veriu -----N.Pasurie 365
Nga Jugu -----N.Pasurie 366
Nga Lindja ----- N.Pasurie 364/14
Nga Perendimi – N.Pasurie 364/16

Prane projektit kalon **Rruga Tepelene-Kelcyre**. Ne kete zone nuk ka patur dhe tani as nuk ka asnje bimesi te larte(dru pyjore ose peme frutore).Kjo zone nuk eshte habitat per specie te rendesishme te flore dhe faunes.

Projekti ndodhet ne Gryka e Kelcyres,Zona Turistike,Kelcyre me keto tregues Urbane:

Siperfaqia e prones	39325 m²
Siperfaqia e Ndertimit	8667 m²
Siperfaqia e Shfrytezimit	24.6%
Numri i kateve	1 Kat
Lartesia e Godines	8.2 m

Pra Shoqeria "TREBESHINA L,t.d " Sh.p.k. me perfaqesuese z.Hari Lena do te zhvilloje projektin "Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore".

E rendesishme eshte te theksojme se rrethimi i sheshit ku jane ndertuar godina e aktivitetit nga ky Subjekt ka sjelle nje impakt estetik pozitiv ne krahasim me gjendjen e meparshme, duke kontribuar e ndikuar ne zhvillim racional dhe pozitiv te kesaj zone.

Investitori privat ka kryer te gjitha studimet perkatese dhe ka bere studimin e infrastruktures inxhinjerike,si dhe studimin e qendrueshmerise se tokes.

10. INFOMACION LIDHUR ME IDENTIFIKIMIN E NDIKIMEVE NË MJEDIS

Metodologjia e identifikimit te ndikimit ne mjedis.

Për parashikimin e ndikimeve në mjedis grupi hartues është bazuar në:

- Krijimin e një baze të dhënash me përgjigjet mbi pyetjet lidhur me problematikat mjedisore dhe analizimin e tyre

- Analizimin e zbatimit të projektit në fushë
- Informimin dhe konsultime me komunitetin dhe aktorët e tjerë të interesuar

Tematika e pyetjeve të cilat formulohen në mënyrë që të identifikohen ndikimet dhe vlerësimi i këtij projekti në mjedis janë:

- A ka përputhshmëri të plotë projekti me ligjet dhe rregulloret përkatëse?
- A do të ndikohen nga projekti kushtet sociale-ekonomike të komunitetit pritës dhe shëndeti i banorëve?
- A do të kenë ndonjë ndikim afatgjatë ose të përhershëm në sistemet ekologjike ose pasuritë natyrore të lokalitetit apo ato që paraqesin interes kombëtar ose rajonal?
- Do të ndikohen komponentët e ndryshëm të ekosistemit të zonës?

Analizimi i zbatimit të projektit në fushë:

Kjo merr në konsideratë pajisjet, makineritë, lëndët ndihmëse, mënyrën e implementimit dhe të realizimit të "Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore", dhe ekipin e nevojshëm për realizimin e tij.

Faktorët dhe Kriteret që zbatohen në Vlerësimin e Ndikimeve të Mundshme

Për të përcaktuar nëse një ndikim negativ në mjedis, gjatë funksionimit të projektit, duhet të reduktohet apo të zbutet, do të bazohet në një ose më shumë nga faktorët e mëposhtëm:

- Krahasimi me ligjet, rregulloret apo me standardet e pranuar (kombëtare dhe udhëzimet dhe standardet ndërkombëtare).
- Konsultimi me vendimmarrësit përkatës dhe me agjencitë e mjedisit, etj.
- Preferencë të kriterëve të pararendura, si zonat e mbrojtura apo zona me ndjeshmëri të lartë mjedisore
- Përputhshmëria me objektivat e politikave qeveritare
- Pranueshmëria e zbatimit të programit nga komuniteti lokal dhe nga banorët e zonës ku do të zbatohet programi.
- Mbledhja e sa më shumë informacioneve dhe njohurive lidhur me temën e projektit, nivel sa më i lartë dhe një gjykim sa më të mirë profesional të ekipit të që harton vlerësimin mjedisor
- Njohje dhe vlerësim më të mirë të vlerave të ekosistemit.

11.MASAT E PROPOZUAR PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Masat Kryesore lehtesuse qe do te ndermerren gjate zhvillimit te Projektit

Vlerësimi paraprak i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe do te zbatohen nga kontratuesit per zbatimin e projektit. Ndikimet negative ne mjedis gjate ndertimit te objektit jane ne nivele te ulta. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte shenuar.

- Lagia e shesheve te pa shtruara te teritorit te aktivitetit per te minimizuar ngritjen e grimcave te ngurta (pluhurave) ne ajer.
- Mbetjet e ngurta urbane qe do te prodhohen ne aktivitet te depozitohen ne vendet e percaktuara nga Njësia Vendore dhe te vendosen kosha te mjaftueshem per numurin e pononjesve.
- Sistemi i shkarkimit te ujerave urbane te jete i lidhur me sistemin e kanalizimeve te zones.
- Te sistemohet dhe rehabilitohen sheshet e lira dhe lulishtet e objektit.
- Te respektohen oraret e qetesise publike dhe te mos punohet ne oret e vona.
- Automjetet e transportit te qarkullojne me shpejtesi te ulet ne zonat e banuara.

Tabela. Rekomandime për Zbutjen e Ndikimeve të Impakteve

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion teknik. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Biodiversiteti	
Vegjetacioni Dëmtim potencial i vegjetacionit	Punime me mbrojtje brënda truallit te Shoqërisë, lagja e tokës. Në asnjë rast të mos çënohen territoret kufitare.
Fauna	
Shqetësim i specieve, dëmtim aksidental i tyre	Oficeri sigurisë ka për detyrë shpërnguljen e çdo specie që jeton brënda zonës së projektit si edhe trajtimin e tyre tek veterineri në rast aksidentesh.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve të CO ₂ ,SO ₂ , NO _x , PM, HC	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brënda teritorit te aktivitetit për raste

(VOC) nga djegia e karburantit të automjeteve lëvizëse	emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi eficient i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i godines ku zhvillohet aktiviteti dhe mjeteve të punës.
Sistemi i kullimit	
Sistemi i kullimit	Rehabilitim i sitemit të kullimit
Monumentet e natyrës dhe të kultures	
Monumentet e natyrës dhe të kulturës	Promovimi i monumenteve të kultures dhe të natyres jane marrë plotësisht në konsideratë gjat zhvillimit te projektit.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në aktivitet.	Vënd grumbullim i diferencuar. Riciklim Transporti ne vendepozitimn e caktuar nga Njesia Vendore
Ujërat e Zeza	Lidhja me kolektorin kryesor te kanalizimeve te zones
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut.

12. PLANI I MANAXHIMIT MJEDISOR

PMM-ja për një komponent Projekti apo një nënprojekt do të përmbajë:

- Vlerësimin e impakteve mjedisore të parashikuara në faza të ndryshme, veçanërisht gjatë funksionimit (përfshirë mirëmbajtjen) dhe dekomisionimit, periudhat kohore gjatë të cilave do të kryen fazat e mësipërme, shkallën e tyre, qëllimin dhe pasoja(t).
- Përcaktimin e nivelit të pranueshëm të secilit impakt, veçanërisht në lidhje me periudhën kohore, zgjatjen në kohë, shkallën, pasojën (t), koston (t), dhe nivelet e lejuara ligjore.
- Kushtet dhe masat që duhen ndërmarrë për të zbutur këto impakte që ka mundësi të dalin në çdo fazë, cilët do të jenë përgjegjës për to, nëse duhet përmirësuar projekti teknik, ose nëpërmjet masave mbrojtëse gjatë zhvillimit te aktivitetit, etj.

- Burimet dhe metodat e kërkuara për monitorimin, matjen dhe vënien në zbatim të tyre (çfarë është për t'u matur, kur dhe ku, nga kush dhe pse); përgjegjësitë institucionale për secilin veprim; dhe kërkesat e nevojshme për ngritjen e kapaciteteve, dhe kostot përkatëse të secilit element.
- PMM-ja do të përmbajë dy dokumente të veçanta: një Plan Zbutës, që merret me aspektet e përshkruara më sipër, dhe një Plan Monitorues që merret me aspektet e përshkruara më sipër. Pritet që të përgatiten në kohën e finalizimit të përfundimit të projektit teknik dhe duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e specifikuar në Vendimin Paraprak të VNM-së të lëshuar nga AKM-ja.
- NJQV-ja ose propozuesit (nëse nuk janë të njëjtë) do të jenë përgjegjës për përgatitjen e PMM-së. Megjithatë në Termat e Referencës së projektuesit të projektit perfshihet përgatitja e PMM. Aty ku nënprojekti kërkon një VNM, do të kërkohet mendimi i specialistëve të VNM para se ky i fundit të finalizohet.

13. PROGRAMI I MONITORIMIT TË NDIKIMEVE NË MJEDIS GJATË ZHVILLIMIT TË PROJEKTIT

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për aktivitetin "Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore", është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë zhvillimit të aktivitetit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) gjatë zhvillimit të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin e projektit dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me projektin.

- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të projektit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajonin e projektit , në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Baza Ligjore e Monitorimit

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2013 "Për mbrojtjen e mjedisit", kreu VI "monitorim i gjendjes së mjedisit";
- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e Vendimit Paraprakt të VNM-së.

Tabela. Baza ligjore për monitorim

Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010	Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007	Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis
VKM Nr.1189 datë 18.11.2009	Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit
VKM nr.103 datë 31.03.2002	"Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 435, datë 12.09.2002	Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë
VKM Nr. 803 datë 04.12.2003	Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit
Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007	Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara
Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004	Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010

Në përputhje me karakteristikat e zhvillimit të aktivitetit dhe në përputhje me bazën ligjore mbi monitorimin, rekomandojmë të monitorohen këto elemente:

Tabela. Monitorimi i parametrave mjedisore

Nr.	Monitorimi	Parametrat që do të monitorohen	Periudha kohore	Frekuenca	Përgjegjësia
1	Cilësia e Ajrit	PM10, SO2, NOx, CO , CO2 ,HC	Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor
2	Emetimi i zhurmave	Niveli i zhurmave në dB	Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor
3	Monitorimi i shpejtësisë maksimale të valës zanore (PPV)		Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 6 muaj	Eksperti Mjedisor
4	Rastet, incidentet e mundshme në vendin e punës	Regjistrimi dhe raportimi i mënyrës së trajtimit	Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë
5	Avari apo defekte të ndryshme të mundshme gjatë operimit	Regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 3 muaj	Oficeri i Sigurisë dhe Drejtuesi i Aktivitetit
6	Dëmtim i vegjetacionit apo të mbjellave	Regjistrohen	Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 6 muaj	Eksperti i Mjedisit
7	Monitorim i zbatimit të kushteve të Vendimit Paraprak të VNM-së	Monitorohen, regjistrohen, raportohen	Nga fillimi i zhvillimit te projektit	Çdo 6 muaj	Eksperti i Mjedisit & Inspektoriati përkatës

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane etj, kryhet sipas disa kriterëve shkencore përsa i përket monitorimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë"

Investitori do të monitorojë këto tregues të trysnisë në mjedis gjatë fazës së zhvillimit të aktivitetit dhe konkretisht elementët e mëposhtëm:

- Për ajrin duhet të monitorojë Lëndën e Ngurtë Pezull (LNP) dhe zhurmat (dB).
- Për ujin, nuk aplikohen detyrime
- Për token, nuk aplikohen detyrime

Per monitorimin e vazhdueshem te ndotjeve.

Stabilimenti i ambllazhimit te ujit mineral natural " TREBESHINA L.t.d " Sh.P.K. detyrohet te njoftoje rregullisht Agjensine Rajonale te Mjedisit per cdo eventualitet dhe problem qe paraqet rrezik per ndotje te mundeshme te ambientit.

Stabilimenti i ambllazhimit te ujit mineral natural " TREBESHINA L.t.d " Sh.P.K. detyrohet te vej ne dijeni Agjensine Rajonale te Mjedisit per cdo ndryshim apo shtesa te aktivitetit qe mund te kene ndikime ne mjedis.

Stabilimenti i ambllazhimit te ujit mineral natural " TREBESHINA L.t.d " Sh.P.K. detyrohet te krijojë kushtet e nevojshme per monitorimin e sakte dhe te vazhdueshem.

Stabilimenti i ambllazhimit te ujit mineral natural " TREBESHINA L.t.d." Sh.P.K. detyrohet te zbatoje te gjitha detyrimet qe rjedhin nga ligji Nr 9010 date 13.02.2003 " Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta", Ligjit Nr 9115 date 27.07.2003 " Per trajtimin mjedisor te ujrave te ndotura", Ligjit nr 8934 date 05.09.2002 " Per mbrojtjen e mjedisit " si dhe gjithë legjislacionin shqiptar ne lidhje me mjedisin.

Stabilimenti i ambllazhimit te ujit mineral natural " TREBESHINA L.t.d." Sh.P.K.ka eficente

- Planin e Veprimit Mjedisor
- Planin e Menaxhimit të mbetjeve (PMM)
- Program monitorimi ambiental

Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet në aktin e miratimit të Vendimit Paraprak të VNM-së dhe në rast të kundert, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe çdo 6 muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen veprimet e kryera të shoqëruara me foto.

14. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Si eksperte mjedisore të licensuar dhe si autore të këtij raporti, me qëllim që të kemi një ndikim minimal në mjedisin e zonës në teresi nga zbatimi i projektit, rekomandojmë:

- Të mirëmbahen mjediset e gjelbëruar në mënyrë të përhershme dhe të mbillen edhe bimë dekorative autoktone në kushte artificiale për të rritur koeficientin e gjelbërimit.
- Të shmanget në maksimum përdorimi i gjeneratorit dhe të reduktohen zhurmat në orët e vona.
- Të kryhet lagia e sipërfaqeve të pa shtruara, si dhe të rrugëve komunikuese.
- Të kryhet rrethimi i godinës së aktivitetit të dhe të vendosen tabela paralajmëruese për rreziqet për kalimtarët dhe punonjësit.
- Të reduktohet qarkullimi në orët e pikut të trafikut, për të mos krijuar trafik të rënduar në zonë.
- Të mos përdoren boritë e mjeteve në qendrat e banuara dhe qarkullimi të kryhet me shpejtësi të ulët.
- Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjentëve nga mbetjet urbane
- Të vendosen postera sensibilizues për punonjësit dhe banoret për një mjedis të pastër.
- Investitori të respektojë detyrimet e vendosura në Vendimin Paraprak të VNM-së që do të miratohet nga AKM.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat e përcaktuara në këtë raport të VNM.
- Subjekti të jetë në dijeni të kuadrit ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset dhe të ndërtohen shkallët e emergjencës.
- Të kryhet monitorimi i mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezultat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoj ndikimet e parashikuara mund të minimizohen duke zbatuar masat e përmendura më sipër.
- Ndikimet do të jenë kryesisht të përkohshme dhe jo të përhershme
- Për ndikimet e identifikuar janë propozuar masat përkatëse me qëllim minimizimin dhe eliminimin e këtyre impakteve.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eliminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e Njesisë Vendore gjithashtu të zbatojë rigorozisht detyrimet e përcaktuara për të garantuar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit.

- Te mbrohen objektet nga gerryerjet siperfaqesore.
- Te respektohen detyrimet dhe kushtet e vena ne lejen/deklaraten mjedisore nga Ministria e Mjedisit.
- Te kryhet monitorimi periodik i aktivitetit si gjate fazes se funksionimit te aktivitetit. Keto te dhena te monitorimit te dorezohen rregullisht prane Drejtorise Rajonale te Mjedisit te Prefektures perkatese, si dhe te vihen ne dispozicion te publikut te gjere dhe organizmave te tjera te identifikuara si pale te prekura ose pale interesi.

Raporti Paraprak per Vlersimin e Ndikimit ne Mjedis shikohet ne perfundim te tij si i pranueshem per ndertimin e ketij projekti. Kjo edhe per faktin se gjate gjithë kohes qe prej ekspertit behej vezhgimi, verifikimi dhe kontrollimi i plotesimit te kushteve te ligjshmerise mjedisore por edhe me tej ne vazhdimesi, drejtuesi i subjektit qe do te kryeje ndertimin tregoi interesim dhe vleresim pozitiv per krijimin e kushteve mjedisore dhe zbatimin e rekomandimeve per mjedisin si dhe ne hartimin sa me te plote te ketij Raporti Mjedisor.

Duke pare masat e marra ne teresine e tyre ne permbushjen e kerkesave te ligjshmerise mjedisore, teknologjike e thjeshte qe do te aplikohet ne rruge te modernizuar, impenjimin per realizimin e ndertimit dhe permiresimet e treguesve mjedisore, mendojme se ndertimi qe do te kryhet ne kete zone nga subjekti nuk do te kete pasoja negative te dukshme te cilat mund te sjellin probleme me ndikim ne mjedis.

Informacion për kontaktin:

TREBESHINA L.t.d

Adresa: Zona Turistike "Gryka e Këlcyrës",

Përmet, Shqiperi

Tel & Fax: +35587524465-66

Mob: +355692067020

E-mail: info@trebeshina.al

Nisur nga sa u paraqit me lart dhe ne dokumentacionin perkates shoqerues, perfundimisht mund te themi se projekti i Subjektit "TREBESHINA L. t.d " Sh.p.k. per projektin " Nxjerrja e ujit nentokesor dhe skemat e tjera per rimbushjen artificiale te ujrave nentoksore ", me vendodhje Gryka e Kelcyres, Zona Turistike, Rruga Tepelene-Kelcyre, Kelcyre, me administrator z.Hari Lena nuk do te sjelle pasoja negative per mjedisin e zones.

Si perfundim mund te themi se projekti qe do te zhvillohet konsiderohet i pershtatshem dhe i pranueshem ne zonen e zgjedhur nga investitori, pa krijuar probleme mjedisore per zonen perreth.

Hartoi materialin

STUDIO MJEDISORE
"UNIVERSAL ENGINEERING 08"
Eksperti i Vlersimit e Auditimit Mjedisor



Çertifikuar nga Ministria Mjedisit
Nr. 11594 Prot, Nr. identifikus 197, date 10.12.2014



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11594 Prot.

Tiranë, më 10.12 2014

Nr. identifikues 197

ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

Z. ARJAN BALA

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

PER VTM PAAAPRAKE
"TRABESHITA L.Ë.D" S.H.K.
KELCYRE

MINISTRI


Lefter KOKA



LN-7543-02-2014

NUS/NIPT: 132311045M

Subjekti: Studime Projektive Minerare

Adresa: TIRANE, TIRANE, Tirane, TIRANE, Rruga e Durrësit, Pallati Bimbashi
Nr.14

Kodi: III.2.A(1+2)

Kod tjetër:

Data e lëshimit: 26/02/2014

Afati i vlefshmërisë: Pa afat

Kategoria

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

Nënkategoria

Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

Veprimtari specifike

1. Ndikim në mjedis
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Emërtimi përshkrues i veprimtarisë

Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis: Auditim
mjedisor. Ndikim në mjedis

Kufizime specifike

Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

Detyrime specifike

Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

Vendi i kryerjes së veprimtarisë

Q: Tirane, Rr: TIRANE, B/K: Tirane, Q/F: TIRANE,
Rruga e Durrësit, Pallati Bimbashi Nr.14

Nënshkrimi i sportelit:

JULIA TRAJA


QENDRA KOMBETARE E LICENCIMIT
NATIONAL LICENSING CENTER





**EKSTRAKT HISTORIKI REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT
“SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”**

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit të subjektit (NIPT)	L32311045M
2. Data e Regjistrimit	11/11/2013
3. Emri i Subjektit	Studime Projektme Minerare
4. Forma ligjore	Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar
5. Data e themelimit	05/11/2013
6. Kohëzgjatja	Nga: 05/11/2013 Deri:
7. Selia	Tirane Tirane TIRANE Rruga e Durrësit, Pallati Bimbashi Nr.14
8. Kapitali	100.000,00
9. Numri i pjesëve 9.1 vlera nominale	100,00 1.000,00
10. Të dhëna mbi shlyerjen e kapitalit	
11. Objekti	Studiues, projektues, mbikeqyres, monitories, konsulent, vleresues, kolaudues, supervizues për kërkim - zbulimin, shfrytëzimin, pasurimin, tregëtimin në import - eksport të mineraleve ndërtimore dhe metaleve, matjet topomarkshederike për veprimtarinë e hapjes së punimeve minerare, kapitale dhe dytesore, tuneleve dhe punimeve kapitale nëntokesore për infrastrukturën rrugore, hidrocentrale naftë-gazsjelles, depo lëndesh plasese dhe objekte të tjera me karakter civil. Drejtimin teknik për





	veprimtarine mirerare te shfrytezimit te mineraleve. Vleresimin dhe rehabilitimin e monitorimin e mjedisit.
12. Përfaqësuesit ligjor Afati i emërimit	Ardian Brako Nga: 05/11/2013 Deri: 05/11/2018
13. Kufizime të kompetencave	
14. Ortakët Pjesët e zotëruara Përqindja e pjesëmarrjes	Halil Bulica 100,00 100,00
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
16. Të dhëna njoftuar vullnetarisht	Emri Tregtar: Studime Projektme Minerare Telefon: 0692149164
17. Statusi	Aktiv

HISTORIKU I REGJISTRIMIT

Data e regjistrimit	Ndryshimi i të dhënave të regjistruara
---------------------	--

Datë: 04/03/2014

Alban Brako

Emri, Mbiemri
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPERISE
"STUDIME PROJEKTIME MINERARE" Sh.p.k

dt. 03/09/2015

KONTRATE PUNE BASHKEPUNIMI

Sot me date 03/09/2015 hartohet kjo kontrate pune bashkepunimi ndermjet :

Subjektit "Studime Projektme Minerare" Sh.p.k, rregjistruar ne Q.K.R. me date 11/12/2013 me numer identifikimi L 32311045 M, me seli ne Tirane, rr. Durresit, pll Bimbashi, nr. 14 me objekt veprimtarie : Studimin, projektimin, mbikëqjen, monitorimin, konsulencen, vlerësimin, kolaudimin, supervizimin për kerkim – zbulimin, shfrytëzimin, pasurimin, tregetimin ne import – eksport te mineraleve ndertimore dhe metalore, matjet topomarkshederike për veprimtarinë e hapjes së punimeve minerare, kapitale dhe dytësore, tuneleve dhe punimeve kapitale nëntokësore për infrastrukturën rrugore, hidrocentrale naftë-gazsjellës, depo lëndësh plasëse dhe objekte të tjera me karakter civil. Drejtimin teknik për veprimtarinë minerare të shfrytëzimit të mineraleve. Vleresimin dhe rehabilitimin e monitorimin e mjedisit.
me **perfaqesues ligjor (administrator) z. Ardian BRAKO**

Dhe

z. Arjan ALI BALA, mbajtes i leternjoftimit nr. 024726440, **çertifikuar** nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe adminstrimit te Ujrave per hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditimin mjedisor, per hartimin e ekspertizave per problem mjedisore dhe thirrjen si ekspert per te vleresuar nje raport te vleresimit te ndikimit ne mjedis ose rezultatet e nje auditimi

Kjo kontrate pune bashkepunimi lidhet ndermjet subjektit "Studime Projektme Minerare" Sh.p.k, dhe z. Arjan BALA ne mbeshtetje te Kodit te Punes, neni 5, pika a, b, per veprimtari ekspertize lidhur me :

- Hartimin e raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis
- Kryerjen e auditimit mjedisor
- Hartimin e ekspertizave per problem mjedisore
- Ekspert vleresues per problemet mjedisore

Kjo kontrate lidhet per periudhen 03/09/2015 deri me 31/08/2016 dhe me te drejten e zgjatjes se afatit.

Kontrata hartohet ne dy kopje nga nje per secilen pale .

Eksperti Mjedisor

Arjan BALA



Subjektit "Studime Projektme Minerare" Sh.p.k

Administrator

Ardian BRAKO

